E mërkurë, 4 mars 2024

[Seancë e hapur]

[Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

--- Seanca fillon në orën 09.30

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të gjithëve.

Znj. Sekretare, paraqisni lëndën ju lutem.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2023-12, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të gjithë të akuzuarve, konstatoj praninë e tyre në sallën e gjyqit.

Paraqitja, përbërja e palëve është e njëjta si dje?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës. Kemi një person tjetër, Claire O'Conell, e cila është e pranishme sot për ZPS-në.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

Mbrojtja ndonjë ndryshim?

ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Në ekipin e Mbrojtjes së Thaçit sot kemi edhe mbrojtësin Luka Misetic. Faleminderit.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

Mund të sillni dëshmitarin në sallë.

Ndërkohë që presim dëshmitarin, z. Holmes, duket që keni një përditësim të kohës që mendoni se do t'ju nevojitet.

Z. HOLMES: [Përkthim] Po, mendoj që do të na duhen 45 minuta.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Do kërkoja që Dëshmitari 9 të jetë atëherë i disponueshëm për të filluar në pjesën e dytë të ditës.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Sigurisht. Faleminderit.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mirëmëngjes, z. Harlaar. Mirë se vini, përsëri. Më dëgjoni?

DËSHMITARI: [Përkthim] Po, ju dëgjoj.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ju kujtoj që jeni akoma nën betim, shpresojmë të mbarojmë me dëshminë tuaj sot në mëngjes.

Përpara se të fillojmë, desha t'ju pyes e keni raportin përpara jush aty ku jeni?

DËSHMITARI: [Përkthim] Po, e kam.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Rees, jemi në rregull.

Z. REES: [Përkthim] Në rregull. Është shumë mirë me neve edhe përdorimi i dokumenteve fizike letër. Është e përshtatshme për të dy palët.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mund të vazhdoni.

DËSHMITARI: KOEN HERLAAR [Vijon]

[Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

Pyetje të palës tjetër nga z. Rees: [Vazhdim]

Z. REES: [Përkthim]

PY. Dje u ndaluam kur po diskutonim defektet e mundshme sa i

takon cilësisë, imazheve që keni marrë. Para se të vazhdojmë me këtë, a mund të sqaroni parimet në vijim, pra, në qoftë se dokumentet që përmbajnë mikropikat janë ngjyrosur nga një makineri tjetër, pajisje tjetër që mund të krijojë modele të përziera që përkojnë?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Përpara se të përgjigjet dëshmitari do të kërkoja të kalojmë në seancë private dhe, në fakt, ishim në seancë private dje kur ndërpremë seancën.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Kalojmë në seancë private.

Z. REES: [Përkthim]

PY. Z. Harlaar.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Nuk jemi akoma në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës,

jemi në seancë publike.

Pyetje të palës tjetër nga z. Holmes:

Z. HOLMES: [Përkthim

PY. Z. Herlaar, mirëmëngjes. Unë do ju bëj disa pyetje në emër të z. Kilaj.

Kjo është një fushë ekspertize shumë e re, apo jo, Dëshmitar?

PË. Po.

PY. Nuk dihet shumë publikisht lidhur me këtë fushë dhe, në fakt, ishte shumë e vështirë për neve që të gjenim literaturë ose që të gjenim informacion bindës që kishte të bënte me këto mikropikat e vogla që paraqiten në fletët e printuara prej disa printerëve. A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

PË. Nuk e kuptova pyetjen.

PY. A pajtoheni me faktin që është një fushë e pazhvilluar shumë, është një fushë e re?

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] E morët përgjigjen. Nuk e di, ndoshta doni që ta pyesni dëshmitarin që të pajtohet me propozimin që bëtë në pyetjen e dytë, apo jo?

Z. HOLMES: [Përkthim] Mendoj që e mora përgjigjen. Mund të kaloj tek pyetja tjetër.

PY. Jo vetëm që është një fushë e panjohur, por kjo është një fushë e cila është e mbrojtur nga marrëveshje ndërkombëtare dhe publiku nuk është se di shumë lidhur me këtë fushë, a është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

PË. Po, është e vërtetë.

PY. Dua të kuptoj pak se sa e re është kjo si temë.

Z. HOLMES: [Përkthim] Kështu që për këtë arsye, do i kërkoja Sekretares që të paraqesë në ekran jetëshkrimin e z. Herlaar. Është një dokument që nuk duhet të paraqitet për publikun. Flitet për dokumentin me numër ERN 127822 deri në 127830 RED. Ju lutem paraqisni faqen e fundit.

PY. Do t'ju shpjegoj, z. Herlaar, ndërkohë që paraqitet dokumenti, është pjesa e shtojcës së përgatitur në fund të jetëshkrimit tuaj. Pra, mendoj që arsyeja që pse e keni shtuar këtë pjesë shtojce është që të jepni pak më shumë shpjegim për ato pjesë të jetëshkrimit tuaj që lidhen me çështjen gjyqësore, a është kështu?

PË. Po, e saktë.

PY. Diku nga mesi i faqes ju mund të shikoni, "Ekzaminim i dokumentacionit për çështjen", ju keni identifikuar 24 çështje të raportuara që kanë të bëjnë me 'pikat e verdha'?

PË. Po.

PY. Domethënë, kaq punë keni bërë në përvojën tuaj prej 16 vitesh për IKH-në?

PË. Po, është e saktë.

PY. Ju i thatë Prokurorëve -- nejse është një çështje të cilën ne e trajtuam, megjithatë, na thatë më herët që departamenti për të cilin keni punuar që merrej me dokumente dhe me printerë është zëvendësuar nga SISA - një departament

tjetër më i madh – në vitin 2018, a është përshkrim i saktë ky, Dëshmitar?
PË. Përkthyesit ma përkthyen që departamenti është zëvendësuar. Por nuk është kështu në fakt. Pra, pyetja është në qoftë se departamenti i dokumenteve dhe i printerëve, në qoftë se puna e këtij departamenti është mbyllur nga IKH-ja dhe në qoftë se, domethënë, i është besuar agjencive të tjera. Domethënë, është mbyllur si departament fare. Megjithatë disa veprimtari që kryheshin prej këtij departamenti në të shkuarën janë shpërndarë dhe janë ngarkuar SISA-s. Dhe SISA si njësi ka ekzistuar dhe më herët. Pra, ka dy nënseksione që kanë të bëjnë me dokumente, me printerë të cilët janë dërguar ose janë pjesë e SISA-s tanimë dhe unë vetë jam nën SISA-n, pra, jam në pjesën e përgjegjësisë së SISA-s.
PY. Sa i takon ekspertizës për mikropikat, kjo ekspertizë ose profesionistët që merresh me mikropikat tanimë janë pjesë e SISA-s, apo jo, që prej vitit 2018?
PË. Po, kështu është.
PY. A pasqyron kjo edhe faktin që sikurse e thashë më përpara fusha e mikropikave është e re?
PË. Jo ekzaktësisht kështu. Jo tërësisht kështu. Sepse IKH-ja nuk është i vetmi laborator në Holandë që kryen analiza, e kam fjalën për analiza të mikropikave. Ka ekspertë të tjerë të cilët merren me këtë fushë përtej IKH-së dhe Bashkimi Evropian po ashtu ka shumë ekspertë të tjerë të cilët janë të

specializuar për mikropikat. Në botë gjithashtu në shumë vende, shumë shtete, ekzistojnë ekspertë të mikropikave. Por në secilin prej vendeve përkatëse, domethënë, është fushë e re relativisht.

PY. Ju po thoni, po prezumoni që kjo është një fushë megjithëse ka dhe persona të tjerë të cilët sigurisht që janë ekspertë të fushës. Por ajo çfarë dua t'ju pyes unë më konkretisht është kështu -- do ta formuloj pak më qartë. Pra, ju e thatë që një prej personave, një prej tre personave -- ju jeni një prej tre personave brenda Institutit për Kriminalistikë të Holandës që keni fushë të ekspertizës tuaj mikropikat, apo jo?

PË. Po. Po, kjo është situata brenda IKH-së.

PY. Na thatë që keni 16 vite përvojë pune me institutin për kriminalistikë të Holandës. Si e poziciononi veten? Mendoni që jeni personi më me përvojë nga këta tre personat që merren me mikropika në IKH apo me më pak përvojë? Si e poziciononi veten në raport me dy kolegët e tjerë?

PË. Nga këta tre persona që punojnë me mikropikat, unë jam personi që kam më tepër përvojë.

PY. Sapo na përmendët që ka agjenci të tjera të jashtme, pra, që ka agjenci të tjera të cilat mund të japin përvojën e tyre forensike brenda Holandës, por është e drejtë, apo jo, të thuhet që për shkak të faktit që bëhet fjalë për një fushë të re, ekspertiza për arsyet e çështjes gjyqësore mund të vijë

vetëm nga instituti juaj, nga IKH-ja, apo jo, pavarësisht faktit që ka agjenci që merren me këtë punë?

PË. Po, e saktë.

PY. Do ju lexoj një pjesë, ose do t'ju bëj një përmbledhje të një pjese të një shënimi të një takimi që keni pasur ju me ZPS-në. Këtu thuhet që pjesa dërmuese e ekzaminimeve tuaja kanë ardhur si rezultat i kërkesave për analizë eksperti të bëra nga gjykatës hetues holandezë në çështje penale, sepse kanë dashur të marrin informacion prej IKH-së për çështje penale në gjykatat holandeze.

Z. HOLMES: [Përkthim] Do i kërkoj Sekretares që të paraqesë këtë dokument së bashku me dokumentin që e kemi aktualisht në ekran në qoftë se është e mundur që ta integrojë edhe këtë dokument. Është shënimi zyrtar që mban datën 10 korrik 2025, me numër ERN 128072 deri në 128080. Paragrafi 10, faqja 4 e dokumentit.

PY. Paragrafi 10, diku nga mesi i paragrafit 10, Dëshmitar, thuhet që:

"Pjesa dërrmuese e ekzaminimeve të ekspertit të Dëshmitarit 8 deri më sot kanë ardhur nga kërkesat për analizë eksperti të bëra nga gjykatësit hetues të gjykatave holandeze ..."

Ndërkohë që më tej thuhet që:

"Aktekspertizat zakonisht i janë dorëzuar gjykatësve hetues holandezë pa dhënë parashtrime me gojë ose dëshmi në

sallën e gjyqit.”

Pra, po ashtu thuhet më tej që:

“Sistemi i gjykatave holandeze përcakton përdorimin dhe/ose shpërndarjen e mëtejshme të aktekspertizave të IKH-së.”

Tani të flasim për 24 çështjet të cilat ju keni trajtuar në karrierën tuaj të lidhura me mikropikat, të gjitha këto raporte që keni bërë lidhur me këto aktekspertiza i janë dhënë gjykatave holandeze? Mund të na e thoni apo jo, keni një përgjigje për këtë, apo jo?

PË. Disa prej këtyre raporteve i janë dërguar gjykatësve hetues, ndërkohë që raporte të tjera i janë dërguar shërbimit të prokurorit sepse zyra e prokurorisë na ka kërkuar, domethënë, prokuroria holandeze dhe disa i janë dërguar gjykatësve dhe disa i janë dërguar zyrës së prokurorisë.

PY. Pra, ju nuk e dini, apo jo, se sa raporte nga raportet e përgjithshme që ju keni hartuar i janë dërguar një gjykatësi hetues ose kanë përfunduar në duart e një gjykatësi hetues; e dini këtë përgjigje?

PË. Jo, nuk di t’ju them. Tani për momentin nuk është se e kam të qartë numrin. Por, gjithsesi, në qoftë se e keni të rëndësishme përgjigjen e saktë, mund të bëj kontrollet e nevojshme dhe mund t’ju jap një përgjigje më vonë.

PY. Po në çështjen në TPNJ që keni qenë disi i përfshirë, kjo çështje kishte të bënte me pikat e verdha apo jo?

PË. Jo, jo, nuk kishte lidhje me pikat e verdha.

Z. HOLMES: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja 7 e jetëshkrimit, që ka numrin e ERN 127828.

PY. Përpara se sa t'ju bëj pyetje lidhur me këtë, z. Herlaar, a kam të drejtë kur them që disa prej çështjeve ku jeni i përfshirë ju mund të kenë qenë thjesht për dhënien e provave për pista të mundshme dhe jo për prova të pranueshme nga Trupi Gjykues? Më thoni, po ose jo, në qoftë se e dini.

PË. Të gjitha raportet e bëra për gjykatësit hetues bëjnë pjesë e dokumentacionit të çështjeve përkatëse. Ndërkohë që në qoftë se këto raporte, aktekspertiza diskutohen apo jo në gjykatë, këtë nuk di t'jua them. Por ajo çfarë mund t'ju them unë është që nuk më është kërkuar asnjëherë që të jap dëshmi me gojë, dhe nuk është normale që unë të jap dëshmi lidhur me aktekspertizat e mia. Domethënë, nuk është diçka standarde në sistemin penal të Holandës, domethënë, zakonisht nuk kërkohemi që të vijmë të japim dëshmi me gojë.

PY. Nuk po pyes për këtë. Por thjesht unë po ju pyesja se sa prej raporteve tuaja janë pjesë e dosjeve gjyqësore, por besoj se ma dhatë përgjigjen.

Të vazhdojmë më tej, ju thoni që në CV-në tuaj, domethënë, jetëshkrimin tuaj, në faqen 7, ju keni dhënë dëshmi tre herë si dëshmitar ekspert. Këtu a përfshihet marrja në pyetje e juaj, apo jo?

PË. Po.

PY. Dhe këto janë herët e vetme, domethënë, vetëm 3 herë gjatë gjithë përvojës tuaj ju jeni thirrur për të dhënë dëshmi si dëshmitar ekspert, kështu?

PË. Po, në një seancë për themelin e çështjes. Jam thërritur gjithashtu edhe në një seancë paraprake jo në sallën e gjyqit, por në dhomat, domethënë, bëhej fjalë për një gjykatës hetues që më ka kërkuar mendim lidhur me pjesën time të punës, dhe kjo ka ndodhur pak herë, disa herë gjatë vitit, po është diçka të cilën unë nuk e kam përmendur në jetëshkrimin tim.

PY. Sa herë ka ndodhur kjo, domethënë, këto seancat paraprake, ju a jeni pyetur lidhur me temën e mikropikave, domethënë, sa herë ju ka ndodhur në përvojën tuaj që në seancat paraprake t’ju jenë bërë pyetje lidhur me mikropikat?

PË. Nuk më kujtohet që të jem paraqitur ndonjëherë përpara gjykatësi hetues dhe të më jenë bërë pyetje lidhur me mikropikat.

PY. Në rregull. Duke iu referuar jetëshkrimit tuaj kam përshtypjen që dy shënimet e para kanë të bëjnë me të njëjtën çështje gjyqësore, apo jo? Nuk e di në qoftë se mund të shikoni, domethënë, dy pikat e para kanë të bëjnë me të njëjtën çështje, apo jo. Më korrigjoni në qoftë se e nuk e kam kuptuar drejt?

PË. Po, keni të drejtë. Është e njëjta çështje por në pika të ndryshme të procedurës së çështjes.

PY. Dhe me sa na thatë, në qoftë se e kam kuptuar drejt

dëshminë tuaj, asnjëri prej këtyre rasteve nuk kishte të bënte me mikropikat, kështu, apo jo, Dëshmitar?
PË. Po, kështu është.
PY. A është një përmbledhje e duhur kjo që sapo do të bëj. Në 24 herët që keni shkruar aktekspertiza për IKH-në, domethënë, në 16 vite përvojë ju keni shkruar vetëm 24 aktekspertiza dhe juve nuk jeni pyetur ose nuk keni dhënë dëshmi për sa i takon mikropikave. Domethënë, thjesht dua të di a e kam kuptuar drejt dhe a është një përmbledhje e saktë e përvojës tuaj?
PË. Po.
PY. Domethënë, ju nuk jeni marrë asnjëherë në pyetje si dëshmitar në këtë çështje lidhur me mikropikat, kështu, apo jo?
PË. Po.
PY. Ekspertiza juaj për sa i takon modeleve të mikropikave nuk i është nënshtruar asnjëherë pyetjeve me përjashtim të ditës së djeshme dhe ditës së sotme, a është kështu, Dëshmitar?
PË. Po, është e saktë.
PY. Tani do ndryshoj temë do flasim për marrëveshjet ndërkombëtare.

Z. HOLMES: [Përkthim] Besoj se kolegu nga ana tjetër do preferonte që ne këtë ta trajtonim në seancë private. Nuk po e kërkoj, po ma merr mendja që Prokuroria do preferonte që këtë ta diskutonim në seancë private.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Çfarë mendon Prokuroria për këtë?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Po unë nuk e di çfarë pyetjesh do të bëjë avokati. Por për të qenë të sigurtë, mirë do të ishte që të kalonim në seancë private. Nëse e gjykojmë që nuk është nevoja që ta trajtojmë në seancë private, sigurisht, që mund të kalojmë në çdo moment në seancë publike.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Për të qenë të sigurtë, është mirë që të fillojmë me seancë private dhe në çdo moment mund të kalojmë në seancë publike sipas rastit.

Kështu që i lutem Sekretarisë të na kalojë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë të hapur.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Seanca ndërpritet deri në orën 12.00.

--- Pauza fillon në orën 11.30

--- Seanca rifillon në orën 11.59

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ju lutem, sillni dëshmitarin në sallë.

Z. EDWARDS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ndërkohë që sillet dëshmitari në sallë, në qoftë se më lejoni, unë nuk do

jem i pranishëm për rreth 20 minuta. Ndërkohë që z. Holmes do jetë përfaqësuesi i Mbrojtjes së z. Kilaj, do kthehem gjatë seancës së pasdites ndërkohë.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Atëherë, sa për planifikim, kini parasysh që na duhet 15 minuta pushim ndërkohë do ndërrohen dëshmitarët. Por, përveç kësaj do të vazhdojmë sipas orarit të rregullt të Gjykatës. Domethënë, pas 15 minutave pushim, do vazhdojmë deri në orën 1.00 pastaj do bëjmë pushimin e rregullt të drekës deri në ornë 2.30, që ta keni të qartë të gjithë.

Faleminderit, z. Edwards.

Z. HAFETZ: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, në qoftë se ju ndihmoj, dua të them për dëshmitarin e fundit, Dëshmitarin 9, më duhen vetëm 45 minuta.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim]

[Dëshmitari vijon dëshminë]

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mirë se erdhët, z. Herlaar.

DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Znj. Menegon, fjala për ju.

ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

PY. Dëshmitar, e di që të dhënat e IKH-së së 2025-s, pra të 22 korrik 2025, mbështetur në marrëveshjet ndërkombëtare, hollësitë e mikropikave nuk bëhen të ditura. A mund të na e shpjegoni çfarë statusi ka Instituti për Kriminalistikë i

Holandës? A është agjenci qeveritare, apo jo, është një institucion i qeverisë, apo jo?
PË. IKH-ja është agjenci e pavarur që funksionon nën Ministrinë e Sigurisë dhe Drejtësisë. Është institucion qeveritar.
PY. Faleminderit. A mund të themi që ju jeni nëpunës civil ose punonjës i sektorit publik? Është përshkrim i saktë ky?
PË. Po, është e saktë.
PY. Faleminderit.

ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Do ju kërkoja të kalojmë në seancë private, z. Gjykatës.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull, le të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, jemi në seancë të hapur tani.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Herlaar, kemi mbërritur në përfundim të dëshmisë tuaj. Ju falënderoj për kohën dhe për përgjigjet e dhëna dhe tani do i kërkoj Sekretares t'ju nxjerrë nga salla a gjyqit. Edhe një herë, faleminderit.

DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit juve, ishte kënaqësi.

[Dëshmitari largohet]

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Sikurse e thashë dhe më parë duhet të bëjmë një pushim prej 15 minutash, në mënyrë të tillë që të përgatitemi për dëshmitarin e radhës.

Është gati dëshmitari, Prokuror?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Po, është gati.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull, atëherë do të bëjmë 15 minuta pushim -- jo, z. Holmes, dëshironi të thoni

diçka?

Z. HOLMES: [Përkthim] Kemi dërguar një kërkesë, domethënë, i kemi -- kemi një kërkesë të shkurtër që ka të bëjë me Dëshmitarin 8, dhe përderisa jemi drejt fundit të dëshmisë së dëshmitarëve të Prokurorisë, ka disa çështja të tjera të cilat u përmendën nga Dëshmitari 8, dhe ne parashtrojnë që lidhen më shumë me drejtësinë e procesit. Dhe pranimin e dëshmisë së tij sepse ne mendojmë dhe parashtrojmë që kjo është një dëshmi e paplotë. Këtë e dimë sepse shumë prej pyetjeve të rëndësishme të bëra prej ekipeve të Mbrojtjes dëshmitari nuk pati mundësi t'i jepte përgjigje.

Kështu që në thelb ne kërkojmë shtatë ditë në mënyrë të tillë që të dorëzojmë parashtrime lidhur me këtë element, në mënyrë të tillë që të trajtojmë aktekspertizën e ekspertit, por, gjithashtu edhe t'ju japë mundësinë, pra, neve dhe gjithashtu dhe ekipeve të tjera të Mbrojtjes që të shprehen lidhur me këtë pikë.

Ka disa çështje të cilat u ngritën në seancë të hapur dje lidhur me çështjen në qoftë se ai do kishte mundësi që t'i përgjigjej pyetjeve apo jo. E kam fjalën këtu për pyetje të cilat mbulohen nga marrëveshjet ndërkombëtare të pretenduara. Nuk mendoj që është e nevojshme të kalojmë në seancë private, megjithatë, do të mundohem që t'i cek këto elementë shumë përciptazi.

Sikurse parashtrohet në parashtrimin F62 [Sipas

përkthimit] të dorëzuara me 15 dhjetor 2025, që është përgjigja e ZPS-së ndaj njoftimit të Mbrojtjes sipas rregullës 149. Në paragrafin 15 ZPS-ja thotë që dëshmitari nuk do të lejohet që t'i përgjigjet aspekteve të caktuara. Domethënë, ka aspekte të caktuara në dëshminë e tij që ai nuk lejohet që t'i japë përgjigje pyetjeve në asnjë forum, por baza për këtë pohim është e trefishtë.

Së pari, është deklarata e bërë nga IKH-ja, nga Instituti për Kriminalistikë i Holandës, dhe për këtë do ju referoja ju, i nderuar Gjykatës - dokumenti 128444, nuk duhet të transmetohet në ekran - por ky është njoftimi i bërë nga IKH-ja i datës 22 korrik 2025. Aty nuk përmendet asgjë lidhur me skenarin që dëshmitari nuk duhet t'i japë përgjigje pyetjeve të caktuara. Në të flitet për bashkëpunimin në seanca të mbyllura, përmendet gjithashtu që dëshmitari do jetë i pamundur që të përmendë hollësi të caktuara në seancë të hapur. Por në këtë shënim, ose në këtë raport të IKH-së nuk përmendet shprehimisht që dëshmitari nuk lejohej që t'i përgjigjet pyetjeve në asnjë format të mundshëm. Dëshiroj që këtë ta them për procesverbal.

Pika e dytë ka të bëjë me atë çfarë ngriti znj. Menegon dje në parashtrimet e veta dhe ka bëjë konkretisht me rregullën 107 dhe nenin 58. Kjo çështje është ngritur për të herë të parë nga vetë ZPS-ja. Dhe sipas ZPS-së kjo është baza që ata i kërkojnë dëshmitarit që mos i përgjigjet pyetjeve

legjitime.

Me të drejtë rregulli 107 sikurse e thatë ju dje, kanë të bëjnë me prova të cilat nuk janë domosdoshmërish të pranueshme, thjesht shtrojnë pistat dhe janë plotësuese. Por, nga ana tjetër në qoftë se përfshihet Mbrojtja e rregullës 107, atëherë, përfshihet Mbrojtja dhe miratimi që duhej të jepej nga palë të treta. Dhe për këtë arsye kërkesa duhej që t'i jepej Panelit përkatës.

Por, një kërkesë e tillë nuk është dorëzuar. Domethënë nuk është kërkuar Mbrojtjes sipas rregullës 107 nga Prokuroria. Duhet të bëhet një kërkesë që ti të marrësh mbrojtjen që ofrohet ose që parashikohet nga rregulla 107. Nuk mund ta prezumosh atë si të mirëqenë. Dhe Prokuroria në këtë rast ka vepruar në mënyrë tërësisht të pajustifikuar.

Dhe sa i takon rregullës 58, i nderuar Gjykatës, në këtë nen parashikohet një parim që vihet në lëvizje nga rregullorja, kështu që nuk është se jep të drejta procedurale për Prokurorinë.

Kështu që thjesht doja që këto parashtrime të mia t'i kontekstualizoja.

Domethënë, në thelb, po kërkoj shtatë ditë duke filluar nga sot në mënyrë të tillë që të dorëzojmë parashtrimet sa i takon vërtetësisë dhe drejtësisë së dëshmisë së dëshmitarit, si edhe tërësisë së cilësisë së dhënies së dëshmisë prej këtij dëshmitari.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Përpara sesa t'i jap fjalën z. Hafetz dhe t'i them atij që të na thotë kundërshtimet e veta në qoftë se ka, lidhur me kompleksitetin ligjor të çështjes dhe fushëveprimit të çështjeve, këto janë arsye për zgjatjen e afatit në shtatë ditë. Domethënë, ju po thoni mbi bazën e parashtrimeve që bëtë se keni nevojë për më shumë kohë, nëse e kuptova drejt?

Z. HOLMES: [Përkthim] Po, po, kjo ishte, absolutisht.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] A jeni dakord juve, është në rregull në qoftë se japim shtatë ditë në dispozicion për paraqitjen e këtyre parashtrimeve prej palëve?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Jo, nuk kemi asnjë kundërshtim. Kështu që është në rregull.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Pasi të bëjmë pushimin prej 15 minutash do marr vendim lidhur me këtë kërkesë.

Atëherë dhe një herë, 15 minuta pushim në mënyrë që të vijë dëshmitari tjetër dhe pastaj kur të vi do marr vendimin.

--- Seanca ndërpritet në orën 12.30

--- Seanca rifillon në orën 12.45

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Pra, kemi marrë një kërkesë që të ndryshojmë afatet që janë të përcaktuara në vendimin 691, pra, në vendimin 691 për parashtrimet në lidhje me ekspertizën e dëshmitarit. Pra, Mbrojtja kërkon të bëjë parashtrime lidhur dhe me aspekte të tjera. Kërkesa në thelb është të shtyhet afati nga dy ditë në shtatë ditë për

dorëzimin e parashtrimeve dhe ZPS-ja ka kërkuar shtyrje të ngjashme nëse ne e miratojmë këtë.

Atëherë, afati për parashtrimet e Mbrojtjes do të jetë e marta e javës tjetër, që më duket se i bie gjashtë ditë, jo shtatë ditë. Dhe ZPS-ja po ashtu duhet të ketë gjashtë për t'u kundërpërgjigjur, që i takon e hëna pas dy javësh. S'i kam datat tani përpara dhe e kam shumë të vështirë ta hap kalendarin në kompjuter, por besoj se jam i qartë.

Z. HOLMES: [Përkthim] Faleminderit.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull. Ju lutem Sekretarisë të sjellin në sallë dëshmitarin e radhës.

[Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] z. Dëshmitar, mirë se erdhët në sallën e gjyqit.

DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ju do të jeni këtu në cilësinë e dëshmitarit të Prokurorisë. Pikësëpari do tua bëjë pyetjet Prokuroria dhe më pas nga një ose më shumë prej ekipeve të Mbrojtjes. Ju lutem, nëse nuk e kuptoni një pyetje, kërkoni që ta përsërisim pyetjen ose që ta sqarojmë, dhe me kënaqësi do ta bëjmë këtë gjë.

Tani do u lutesha të lexoni betimin solemn që keni përpara.

DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj

solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën, dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

DËSHMITARI: CHRISTOPHER KELLY

[Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, tani jeni nën betim për të thënë të vërtetën dhe nëse nuk thoni të vërtetën mund të ndiqeni penalisht në juridiksionin e Dhomave të Specializuara.

DËSHMITARI: [Përkthim] E kuptoj.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Hafetz, fjala është për ju.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit.

Pyetje nga z. Hafetz:

Z. HAFETZ: [Përkthim]

PY. Mirëdita. Ju lutem, a mund të na thoni emrin?

PË. Christopher Kelly është emri im.

PY. Z. Kelly, unë do t'ju bëj disa pyetje përreth 45 minuta ose një orë. Tani jemi në seancë të hapur, ç'ka do të thotë se procesin po e ndjek dhe publiku dhe mendoj se do të mbetemi në seancë publike për gjatë gjithë dëshmisë suaj.

Sidoqoftë, në qoftë se ju mendoni se unë ju kam bërë një pyetje, përgjigja e së cilët kërkon dhënien e informacionit konfidencial, ju lutem, më vini në dijeni në mënyrë që të kalojmë në seancë private. E kuptuat këtë?

PË. Po.
PY. Si fillim unë kam disa pyetje për ju. A jeni kontraktor me kohë të pjesshme për Dhomat e Specializuara?
PË. Po.
PY. Për sa kohë keni qenë kontraktor me kohë të pjesshme?
PË. Pak më shumë se dy vjet.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ju lutem, bëni një pauzë midis pyetjeve dhe përgjigjeve në mënyrë që të përfundojë përkthimi.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Pra, në përgjithësi çfarë pune bëni ju për ZPS-në në kuadër të kontratës tuaj?
PË. Hetim i forensikës dixhitake.
PY. A keni përvojë në organizata të tjera përveç ZPS-së sa i takon pajisjeve dixhitale, përfshirë telefonat celularë dhe kompjuterët?
PË. Po.
PY. Me përafërsi sa vite përvojë keni ju në këtë punë?
PË. Rreth 26 vjet.
PY. Kjo përvojë për nxjerrjen e të dhënave nga aparatet dixhitale, a përfshin dhe punën me programimin që njihet Cellebrite dhe Magnet?
PË. Po.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Shohim në ekran materialin SPOE129373-129380.

PY. Z. Kelly, gjatë punës tuaj me ZPS-në a ju kujtohet të keni shkruar disa dokumente që në vija të përgjithshme tregojmë mënyrën se si keni kryer disa prej -- se si keni bërë disa prej heqjeve të të dhënave?
PË. Po.
PY. A keni përgatitur disa shënime zyrtare që i keni nënshkruar më pas ku keni përshkruar më në hollësi punën që keni bërë?
PË. Po.
PY. Në të majtë të ekranit është anglishtja, a është ky një prej shënimeve që keni shkruar ju?
PË. Po.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Ju lutem, të shkojmë në faqen e fundit.

PY. A është ky nënshkrimi dixhital?
PË. Po.
PY. Kohët e fundit a keni pasur mundësi ta rishikoni dokumentin apo të bëni korrigjime apo ndryshime të tij?
PË. Po.
PY. Në fakt, a keni bërë dy korrigjime thjesht për gabime në dokument?
PË. Po.
PY. Keni bërë dhe një ndryshim të vendbanimit --

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Hafetz, përkthyesit ju bënë një vërejtje, ju lutem. Ju lutem, dhe dëshmitarit, ju

lutemi bëni një pauzë midis pyetjeve dhe përgjigjeve. Z. Hafetz, edhe ju, ju lutem.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Do ngadalësoj.

PY. Të kthehemi tani. A keni pasur mundësi ta rishikoni tërësisht shënimin dhe të bëni korrigjime përkatëse?

PË. Po.

PY. Që të jemi të qartë, dy korrigjimet që bëtë ju ishin thjesht gabime të vogla ortografike?

PË. Po.

PY. Një ishte një gabim ortografik për vendimin tuaj, apo jo?

PË. Po.

PY. Përveç këtyre dy korrigjimeve të vogla pjesa tjetër e dokumentit a është e vërtetë dhe e saktë me aq sa keni ju dijeni?

PË. Po.

Z. HAFETZ: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të vendosë në ekran materialin 129384 deri në 129387.

PY. Z. Kelly, e njihni dokumentin në të majtë të ekranit?

PË. Po.

PY. A është ky një prej dokumenteve të tjera që keni hartuar ju kur keni përmbledhur punën që keni bërë për ZPS-në?

PË. Po.

Z. HAFETZ: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të shkojë në fund të dokumentit.

PY. Është nënshkrimi juaj ky në fund të faqes, nënshkrimi

dixhital?

PË. Po.

PY. z. Kelly a ju është dhënë mundësia kohët e fundit ta shihni dhe një herë këtë dokument që të bëni ndryshime apo korrigjime?

PË. Po.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Shkojmë në faqen 2 të dokumentit. Paragrafi 3.

PY. Z. Kelly, korrigjimi i vetëm që keni bërë ju në këtë dokument a mos është shtimi parafjalës "the" në anglisht përpara emrit Mustafa?

PË. Po.

PY. Përveç këtij gabimi ortografik, pjesa tjetër e dokumentit a është e saktë dhe e vërtetë me aq sa keni ju dijeni?

PË. Po.

Z. HAFETZ: [Përkthim] I lutem tani Sekretarisë të shohim materialin 129388 deri në 129393.

PY. Z. Kelly, e njëjta pyetje, në të majtë të ekranit, a është një dokument që e njihni?

PË. Po.

PY. A është një prej dokumenteve të tjera që keni shkruar ju në kuadër të punës tuaj për ZPS-në?

PË. Po.

Z. HAFETZ: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të shkojmë në fund të faqes 393.

PY. Edhe një herë, nënshkrimi që shohim në fund të faqes është nënshkrimi juaj?
PË. Po.
PY. A ju është dhënë mundësia kohët e fundit ta rishikoni dhe një herë këtë dokument që të bëni korrigjime?
PË. Po.
PY. Për këtë dokument nuk kishit korrigjime, apo jo?
PË. Po.
PY. Pasi patët mundësinë ta shihnin dokumentin, a mund të na thoni tani që përmbajtja e këtij dokumenti është e saktë dhe e vërtetë me aq sa keni ju dijeni?
PË. Po.

Z. HAFETZ: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, në bazë të vendimit tuaj 687, të tri këto dokumente kërkojmë që të pranohen si prova gjyqësore sepse gjykojmë që kanë përmbushur rregullën 154. Kështu që do ju luteshim që dokumentet të pranoheshin, dhe gjithashtu do ju luteshim që të gjitha provat materiale shoqëruese me përjashtim të katër syresh të pranohen po ashtu si prova materiale.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Kelly, këto tre deklarata a reflektojnë atë që do të thonit sërish ju sot në sallën e gjyqit nëse do ju bënin pyetje për të njëjtat tema?

DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Tri deklaratat, fillimisht,

në fakt, duhet të pyes ekipet e Mbrojtjes nëse kanë kundërshtime.

Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim. Por, besoj se provat materiale shoqëruese janë provat materiale shoqëruese që janë miratuar paraprakisht nga Trupi Gjykues, kështu që në këtë pikë ne nuk kemi kundërshtime.

PËRKTHYESJA: Nuk kemi kundërshtime nga ekipet e tjera të Mbrojtjes.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull.

Atëherë, tri deklaratat pranohen si dhe provat materiale shoqëruese. ERN-të janë parashtruar në parashtrimin 635, Shtojca 2, me përjashtim të dokumenteve që nuk janë pranuar në bazë të vendimit me numër F687, i cili është lëshuar më 22 janar 2026. Me përjashtim, pra, të këtyre materialeve të gjitha materialet e tjera pranohen.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Janë katër prova materiale që po kërkojmë të mos pranohen. Janë në tabelën në faqen 2. Këto janë komunikuar edhe palëve edhe Gjykatësit paraprakisht. Por procesverbal do t'i lexoj.

Nuk kërkojmë pranimin e 125683-125655 [Sipas përkthimit]. Nuk kërkojmë pranimin e 128799-128086 [Sipas përkthimit]. Nuk kërkojmë pranimin 125087 [Sipas përkthimit] deri në 1250 -- 125709. Dhe po ashtu, nuk kërkojmë 125710 deri në 125714. Këtë kishim për momentin.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

Sekretaria.

[Gjykatësi i Vetëm dhe Sekretarja e Gjykatës këshillohen]

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Sekretaria do ju qarkullojë një listë që të sigurohemi se çfarë do të pranohet dhe çfarë nuk do të pranohet. Dhe nëse ka ndonjë gabim ju lutem na njoftoni brenda ditës së sotme.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit. Është dhe një material tjetër, Shënimi 3. Unë fillova me Shënimin 1 po është dhe një material me Shënimin 3 që nuk po kërkojmë të pranohet. Për hir të palëve po ju them që është SPOE00346751 deri në 00346770.

Nuk po kërkojmë pranimin e provës së fundit materiale sepse është provë që është pranuar.

Do i lutesha Sekretarisë tani të vendosë në ekran materialin 129950.

PY. Z. Kelly, shihni në të majtë të ekranit tuaj. A e njihni dokumentin në të majtë?
PË. Po.
PY. Ju e keni hartuar?
PË. Po.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Shkojmë në faqen e fundit të dokumentit, ju lutem, 129954.

PY. A është ky nënshkrimi juaj?
PË. Po.

PY. Ky dokument a përmban një përmbledhje të punës që keni bërë ju për nxjerrjen e të dhënave nga aparatet dixhitale njësoj si shënimi i parë që pamë?
PË. Po.
PY. Përpara se të vinit sot në Gjykatë, a keni pasur mundësi ta rishikoni këtë dokument?
PË. Po.
PY. Përmbajtja a është e saktë dhe e vërtetë me aq sa keni ju dijeni?
PË. Po.
PY. Dhe nëse do t'ju pyesnin sot në sallën e gjyqit lidhur me faktet që përmban ky dokument, a do të jepnit të njëjtat përgjigje?
PË. Po.

Z. HAFETZ: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nëse nuk ka kundërshtime kërkojmë pranimin e dokumentit të katërt, i cili mban disa të prova të tjera materiale që dua t'i diskutoj me ju që janë nxjerrë nga aparati celular në të njëjtën mënyrë siç është përshkruar në shënimin e parë.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mbrojtja.

Z. MISETIC: [Përkthim] Fillimisht, unë nuk e kam të qartë tani çfarë rregulle po vëmë në lëvizje ne këtu se kjo nuk është kërkesa sipas rregullës 154, e kam të paqartë tani për cilën rregull po flasim. Ju lutem një sqarim, cilën rregull po vendosim, po vëmë në lëvizje për të pranuar këtë material?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Sipas rregullës 138, po nëse preferon avokati ose Gjykatësi mund t'i marrim një për një materialet.

Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kemi kaluar pushimin e drekës, na jepni kohë t'i shqyrtojmë njëherë këto provat edhe pas pushimit të drekës do ju njoftojmë.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit që na njoftuat. Keni të drejtë, e kam kaluar pushimin e drekës. Në këtë pikë, ju lutem, palëve që gjatë pushimit të drekës të konsultohen me njëra-tjetrën dhe të shohim nëse mund të gjejnë një marrëveshje, përndryshe do të marr unë një vendim.

Në rregull, bëjmë pushim deri në orën 2.30. Faleminderit.

--- Pauza e drekës fillon në orën 13.06

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

--- Seanca rifillon në orën 14.29

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mirëdita. Mund të sillni dëshmitarin në sallë.

Z. Hafetz, do të përfundojmë me pyetjet tuaja në qoftë se jeni akoma juve duke bërë pyetje, do përfundojmë në 3.55 për t'u marrë me disa çështje, megjithëse mund të ndodhë që të jetë Mbrojtja duke i bërë pyetjet.

Misetic, ju e keni fjalën.

Z. MISETIC: [Përkthim] Për të plotësuar atë që po diskutonim përpara pushimit, patëm mundësinë që të bisedojmë me ZPS-në, dhe Mbrojtja dhe Thaçit nuk kundërshton pranimin e

atyre shënimeve sipas rregullës 138.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ka ndonjë kundërshtim --

Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe që të shtoj edhe provat materiale shoqëruese.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ndonjë kundërshtim nga Mbrojtja?

Z. REES: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

Z. HOLMES: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Vërej që nuk ka kundërshtime nga Mbrojtja e Fazliut dhe falënderoj palët për bashkëpunimin e tyre konstruktiv.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Hafetz, ju e keni fjalën.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit shumë, do përpiqem të vijoj më ngadalë me qëllim që përkthimi të bëhet.

Duke qenë se kemi plotësuar kushtet sipas rregullës 138 për pranimin e dokumentit 129950 deri në 129954, paraqes shënimin e datës 5 shkurt 2026, që është hartuar nga Dëshmitari 9, dhe paraqes gjithashtu provat materiale shoqëruese në tabelë në faqen 2 të të njëjtit dokument, po sipas të njëjtës rregull. Vërej se dy prej këtyre materialeve janë tashmë të pranuara, pra, dokumenti P174 dhe P15. Në total, bëhet fjalë për tetë prova materiale shoqëruese.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Këto dokumente pranohen. Sekretarja e Gjykatës do të shpërndajë listën e dokumenteve të tjera palëve, pra, do t’jua shpërndajë këtë listë, në qoftë se deri nesër në mëngjes nuk do ketë kundërshtime këto dokumente do të vlerësohen si të pranuara.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Faleminderit.

Tani në qoftë se do të mund t'i kërkoj Sekretares të shfaqë në ekran dokumentin ERN 125701 deri në 125703. Dhe do të kërkoja që pjesa e pjesshme ET të shfaqet krahas këtij dokumenti.

Dhe që të informoj Gjykatën, kjo është një prej dy provave materiale që do t'i tregoj për -- që mund të transmetohen për publikun, por kjo nuk është një prej tyre. Pra, kjo mbetet konfidenciale.

PY. Z. Kelly, ky që shihni këtu, ky dokument, është një prej dokumenteve që keni nxjerrur nga telefoni i Rrustem Mustafës?
PË. Po.
PY. Dhe ju keni verifikuar se të dhënat e këtij telefoni ishin në imazhin forensik të telefonit, apo jo?
PË. E saktë.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Mund të kalojmë në faqen.

PY. Dhe do t'ju bëj disa pyetje që mendoj na ndihmojnë të kuptojmë punën që është bërë, pra, informacioni që gjendet në këto rreshta, kolona, është i tillë që mund të zbatohet për materialet e tjera që ju keni nxjerrur nga atje?

Pra, është në pjesën e sipërme të majtë të tabelës, në anën e majtë të ekranit tuaj.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Në anën e majtë. Në cep fare të majtë.

PY. Dhe aty thuhet: "Chat WhatsApp"?

PË. E saktë.

PY. Pra, këto dy materiale më poshtë janë mesazhet të WhatsApp-it të nxjerrura nga telefoni i z. Mustafa, apo jo?

PË. Po.

PY. Dhe numrat po të fillojmë me numrin e kolonës, pra, në anën e majtë, në cepin e majtë, kemi 1, 2. E shikoni këtë?

PË. [Nuk ka përkthim].

PY. Është numri rendor sipas të cilit kanë ndodhur në kohën kur janë nxjerrur nga telefoni?

PË. Po.

PY. E keni fjalën, pra, mesazhi i parë, numër 1, është?

PË. E saktë.

PY. Kategoria e "Pjesëmarrësve", për çfarë, kujt i referohet?

PË. Këto janë dy personat që kanë marrë pjesë në këtë bisedë konkrete.

PY. Dhe kur thuhet "në pronësi", apo "pronari" i referohet kjo z. Rrustem -- lidhur me z. Rrustem Mustafa? Kujt i referohet sa i takon pajisjes?

PË. Pajisje -- është pronari i pajisjes.

PY. Dhe pastaj menjëherë poshtë saj kemi emrin e Hajredin

Kuçit, dhe a do të thotë kjo që biseda, pra, ky shkëmbim mesazhesh është midis telefonit të z. Mustafa dhe telefonit të z. Kuçit?
PË. Është midis atyre, pra, atyre dy individëve që janë të identifikuar, personat e identifikuar në WhatsApp. Për këta persona është e saktë, po.
PY. Dhe që të jem pak më i saktë për këtë, ky është numri i telefonit që është regjistruar në këtë telefon i Hajredin Kuçit?
PË. E saktë.
PY. Nuk e dini nëse është telefon pronë e Hajredin Kuçit, i përket atij, për shembull, që është në këtë dhomë, apo jo?
PË. E saktë.
PY. Dhe në qoftë se shkojmë në të djathtë mund të shohim që nga kolona aty për çfarë pjesa “nga”, “prej”, për çfarë -- çfarë pasqyron kjo?
PË. Ky është pjesëmarrësi që ka dërguar mesazhin.
PY. Pra, në rastin e mesazhit të parë është dërguar nga telefoni i Hajredin Kuçit apo në emër të Hajredin Kuçit në këtë pajisje të z. Mustafa; a është saktë?
PË. E saktë.
PËRKTHYESI: Përkthyesit kërkojnë të flasin më ngadalë.
Z. HAFETZ: [Përkthim]
PY. Dhe “Ora: Koha dhe ora e printuar, e stampuar” aty kujt i referohet?

PË. Kjo është data dhe ora kur është dërguar mesazhi.
PY. Dhe çfarë do të thotë UTC+2?
PË. UTC është një akronim për kohën universale të koordinuar, pra, me fjalë të tjera është formati që ne kemi për të zbatuar dhe për të përdoruar kohën, orën, me qëllim që të kemi orën vendore të duhur kur dërgohet një mesazh. Pra, kemi dy orë më pak nga UTC.
PË. Në qoftë se shkojmë pak më poshtë në të djathtë, kolona "Përmbajtja" i referohet tekstit, mesazhit, pra, që është shkëmbyer, në fakt, midis telefonave?
PË. Po.
PY. Pak më në të djathtë tani, a e keni zbatuar ju këtë përkthim të ZPS-së apo ju është dhënë juve pasi është bërë? Pasi keni nxjerrë këtë përmbajte në shqip?
PË. Përkthimi është bërë nga ZPS-ja pasi unë kam nxjerrë përmbajtjen.
PY. Menjëherë në të djathtë të përkthimit të kolonës ku është përkthimi i ZPS-së thuhet "Statusi", për çfarë bëhet fjalë?
PË. Statusi është rezultati i mesazhit. Dhe këtu mund të shihet se mesazhi i parë i këtyre mesazheve si "i lexuar2" dhe se pjesëmarrësi, pra, e ka lexuar mesazhin. Dhe i dyti prej këtyre dy mesazheve thotë që është dorëzuar.
PY. Në përgjithësi, gjatë nxjerrjeve të përmbajtjeve nga telefonat që ju keni bërë në këtë çështje, mesazhet e WhatsApp, a kishin karakteristika të përgjithshme siç janë

paraqitur këto këtu?
PË. Po.
Z. HAFETZ: [Përkthim] Tani do i kërkoj Sekretares të nxjerrë në ekran SPOE00398224. Dhe për procesverbal kjo është -- këtë e bëjmë më vonë. Kjo mund të bëhet publike. Pra, mund të transmetohet.
PY. E njihni këtë?
PË. Po.
PY. Çfarë është kjo?
PË. Kjo është një provë materiale që dokumenton evidenton bisedën përmes mesazheve, bisedë me mesazhe përmes WhatsApp përmes identifikuesve të telefonit apo personave të identifikuar të telefonit për Fahri Fazliun dhe Rrustem Mustafën.
PY. Ju e keni krijuar këtë?
PË. Po.
PY. Çfarë pajisjesh keni përdorur për ta krijuar atë? Çfarë pajisjesh keni përdorur, pra, për të krijuar atë?
PË. Pra, përmbajtja e prove materiale është krijuar për të përdorur disa materiale nga iPhone i z. Mustafa dhe iPhone i z. Fazliu.
PY. Janë vetëm shtatë faqe, në qoftë se mund të na shpjegoni pak çfarë paraqitet këtu në faqen e parë?
PË. Në anën e majtë të ekranit kemi të dhënat të nxjerra që janë metadatat e mesazhit në të djathtë, përfshirë datën,

orën, dërguesin si edhe përmbajtjen e përkthyer të mesazhit, dhe burimi i kësaj përmbajtje në veçanti është iPhone i z. Mustafa. Kemi një pjesë të bisedës, në fakt, janë tre faqe këtu të bisedës midis dy pjesëmarrësve “between” -- midis dy pjesëmarrësve në bisedë, pra, kemi -- kjo është e para prej tyre. Fillon në orën -- me 26 qershor 2023, në orën 19:05. Dhe ky segment në veçanti, ky fragment i bisedës përfundon 19:12.58.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Tani të kalojmë në faqen e dytë.

PY. Në përputhje me atë që thatë ju, kjo është data e dytë nga tre mesazhe që ju keni nxjerrë, pra, a është e saktë?

PË. E saktë.

PY. Këtu kemi segmentin e dytë nga tre segmente, pra, këtu kanë qenë tre ditë të veçanta, ku janë bërë bisedat WhatsApp midis këtyre dy pajisjeve dhe ky është segmenti 2. Kjo ka ndodhur -- kjo është bërë në shtator - kërkoj ndjesë - me 29 qershor 2023, midis orës 9:40:41 dhe deri 10:02:08.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Znj. Sekretare, në qoftë se mund të kalojmë tek faqja e tretë.

PY. A janë këto mesazhe të datës 3 korrik që ju i keni nxjerrur nga telefoni i z. Mustafa?

PË. Po.

PY. Tani do të doja të kalojmë në faqen e katërt, dhe do të doja të na sqaronit çfarë paraqitet këtu duke filluar me tabelën e parë?

PË. Pyetja ishte kur bëhet fjalë për këto mesazhe të WhatsApp, pra, -- kur bëhet fjalë për përputhjen e këtyre mesazheve apo nëse ato ishin -- gjendeshin, përputheshin, pra, këto mesazhe -- që përputheshin, gjendeshin edhe në iPhone e z. Fazliu. Ato nuk ishin gjetur përmes kërkimit, nuk mund t'i gjeje ato apo t'i kërkoje dhe t'i gjeje duke përdorur teknika teknike. Pra, hapi vijues do të ishte që të analizohej baza e të dhënave ku mesazhet duhet të ruhen.

Kur hyn në databazë mund të shoh se aty mungojnë të dhënat në këtë databazë, pra, me fjalë të tjera secili mesazh brenda mesazheve -- secili mesazh i WhatsApp-it ruhet në një bazë të dhënash, dhe secili prej këtyre dosjeve ka një numër identifikues për të, duke e shikuar datën dhe orën si dhe të dhënat identifikuese mund të shihen boshllëqet midis këtyre mesazheve.

PY. Dhe këto boshllëqe përfaqësohen nga kolona e "Çelësit primar, kryesor" në anën e majtë të secilës tabelës?

PË. Po. Dhe në qoftë se shihet kolona e "Çelësit primar" 38, ose rreshti që fillon me 38450, aty është mesazhi. Ky është shënjimi, pra, regjistrimi i mesazhit dhe ju mund të shihni aty orën, që është data dhe ora, 26 qershor 2023, 14:52. Pra, jep kontekst se ku janë, ku gjenden këto të dhëna.

Dhe shihet në identifikuesin çelës të tjerë parësorë apo identifikuesin e të dhënave në vijim, pra, pas këtij, është data 27 qershor në orë 12:26:38. Pra, këto të dhëna, me fjalë

të tjera, ekzistojnë brenda bazës së të dhënave. Numrat e tjerë që mbesin, pra, për të dhënat midis 50 dhe 74, pra numrat 51 deri në 73, nuk janë në këtë databazë.
PY. Dhe kjo pasqyrohet në kutinë në anën e majtë ku thuhet 23 të dhëna që mungojnë në këtë segment -- në segmentin 1.
PË. E saktë.
PY. Dhe është e saktë që për 29 qershorin në telefonin Fahri Fazliu mungonin 16 të dhëna?
PË. Po.
PY. Dhe për 3 korrikun, mungonin 15?
PË. E saktë.
Z. HAFETZ: [Përkthim] Dhe për të ilustruar këtë, në qoftë se mund të shfaqim në të djathtë të ekranit faqen e tretë të provës materiale.
PY. Në këtë dritare, pra ora është 14:20:11 deri në 17:36:10, data 3 korrik, kemi mesazhe që përkojnë në telefonin, pra, të Rrustem Mustafës me Fahri Fazliu që nuk janë, nuk gjenden, pra, këto të dhëna në telefonin e Fahri Fazliut?
PË. E saktë.
PY. A përputhet kjo me fshirjen e mesazheve nga telefoni i Fazliut?
PË. Po.
PY. A ke ndonjë shpjegim tjetër për humbjen apo mungesën e këtyre të dhënave që shihet në një telefon dhe nuk gjinden në telefonin tjetër?

PË. Ka disa mënyra që mesazhet mund të fshihen, por në një moment të caktuar kërkohet një veprim që të duhet të bëhet për hequr këto mesazhe apo për të hequr të dhënat e tyre, do të thoja më saktë.
PË. Dhe ju, që ta mbyllim këtë, nuk e dini nëse kjo ka qenë e qëllimshme apo jo në këtë rast?
PË. Nuk e di.
PY. Në qoftë se këto janë fshirë, bëhet fjalë.
PË. Saktë. E saktë.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Tani do kërkoj të shfaqet në ekran SPOE00403537. Edhe kjo mund të transmetohet për publikun.

PY. E njihni këtë?
PË. Po.
PY. E keni krijuar këtë hartë?
PË. Po.
PY. A mund të na shpjegoni shkurtimisht çfarë përfaqëson kjo?
PË. Po. Kjo është një hartë e të dhënave të vendndodhjes që vjen nga iPhone të ndryshëm. iPhone i parë është iPhone që i atribuohet z. Bashkim Smakaj, dhe i dyti është ai që është përdorur apo marrë nga Bislim Zyrapi.

Të dhënat e vendndodhjes që shihen të përcaktuara këtu, pra, është -- janë eksportuar nga Cellebrite dhe pastaj kemi marrë koordinatat që janë në nxjerrjen, pra, materialet e nxjerrura nga Cellebrite dhe i kemi vendosur ato në Google Earth. Pra, informacioni këtu është në përputhje me

teknologjitë që janë specifike për Apple, pra, telefoni Apple iPhone mbledh informacione lidhur me karakteristikat normale të vendndodhjes që kur ju, kur personi që e mundëson këtë gjë në telefon. Dhe vendndodhjen që janë të rëndësishme për juve, për shembull, ato quhen vendndodhje të rëndësishme, vendndodhje që janë të rëndësishme për juve kanë informacion që ruhet në telefon dhe që, në fakt, është praktikisht është zona, zona konkrete ku ju keni udhëtuar, ku keni qëndruar dhe koha dhe ora e hyrjes dhe e daljes në ato zona të caktuara.

PY. Çfarë përfaqëson pika ngjyrë portokall dhe blu që e keni paraqitur këtu?

PË. Pra, mënyra se si iPhone, mënyra se si kjo teknologji e veçantë funksionon është se vetë zona përkufizohet me kalimin e kohës. Pra imagjinoni që njëra prej zonave është një zone domethënëse e rëndësishme, apo ka -- është një zonë e rëndësishme për telefon, për një iPhone, për një përdorues të iPhone konkret. Për shembull, e zëmë që kjo zonë e rëndësishme është shtëpia. Vetë pajisja kritikon -- krijon një perimetër virtual që ne e quajmë gjeorrethim, pra, rreth shtëpisë dhe pastaj ne marrim mesin e kësaj. Pra, duhet të jetë mesi i perimetrit virtual apo ai gjeorrethimit dhe përcaktojmë se praktikisht qendra -- kjo është qendra e gjeorrethimit.

Pikat që ju keni parë këtu në hartë dhe koordinatat që shihni në anën e majtë të ekranit poshtë pikës së kuqe janë, në fakt, koordinata të vërteta të nxjerrura, të eksportuara

nga Cellebrite për këtë vendndodhje me rëndësi si dhe ora, kohët dhe oraret e hyrjet e daljes nga -- të këtyre telefonave nga këto -- nga kjo vendndodhje në datën specifike, 24 -- në datën konkrete 24 tetor 2023.
PY. Pra, në qoftë se ju kuptoj saktë pika blu, pikat blu dhe protokollet janë -- nuk do të thojnë që janë vendndodhja konkrete ekzakte e secilit telefon gjatë asaj -- atij momenti kohor; është e saktë?
PË. E saktë.
PY. Pra është një përafërsi, apo jo?
PË. Telefonat kanë qenë diku në atë zonë, pra, gjeorrethim që mund ta quajmë atë perimetër. Kjo është qendra e asaj, e asaj perimetri.
PY. A e dini pak a shumë sa është e gjerë kjo zonë, pra, ky perimetër?
PË. Besoj për iPhone e z. Smakaj ka qenë rreth përafërsisht 32 metra, ndërsa për iPhone e Zyrapit ka qenë rreth 24 metra.
Z. HAFETZ: [Përkthim] tani do të kërkoja znj. Sekretare që të - dhe kjo do jetë konfidenciale - të shfaqë në ekran dokumentin SPOE0036637. Faleminderit.
PY. E njihni këtë dokument?
PË. Po.
PY. Keni nxjerrë të dhëna nga ThinkPad Lenovo i z. Smakaj?
PË. Jo.
PY. I keni analizuar këto, këtë material?

PË. Po.
PY. Dhe a keni konfirmuar praninë e tij në laptopin e z. Smakaj?
PË. Po.
PY. A mund të na shpjegoni këtë kolonën e "burimit", çfarë përfaqëson kjo?
PË. Kolona e "burimit" është vendi ku mund të gjendet dokumenti në laptop. Pra, në fillim kemi emrin e imazhit. Pra imazhi është një kopje e vetë të dhënave që është në pajisjen fizike dhe -- ose lloj tjetër mediash që vijnë nga sistemi i kompjuterit. Pra, ky numër që ju shihni fillon me -- është numër me shkronja dhe me shifra dhe fillon me AADX, dhe është krijuar nga dhënësi forensik që bërë imazhin.

Pastaj shihen disa metatëdhëna që tregojnë Microsoft NTFS, që është informacioni, pak informacion lidhur me vetë kompjuterin.

Pastaj vija e parë, që e kemi aty ndarëse, shohim "Përdoruesit", dhe kjo në fakt është profili i përdoruesit, apo përdoruesit Windows të profilit -- profili i përdoruesve Windows ku janë ruajtur të gjitha këto.

Pastaj kemi rreshtin.

Pra, në vijim është ajo që shihet vetëm këtu në rreshtin 23, është një nënkategori apo vendndodhje brenda profilit të përdoruesit që quhet ekrani, pra, i përdoruesit.

Dhe pastaj në këtë kategori që quhet Desktop, pra,

ekrani, kemi “desktopi2022”, dhe kjo është një dosje që është me dokument word, pra, docs1.docx, dhe aty gjendet.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Në qoftë se mund t'i -- tani do i kërkoj Sekretares që të shfaqë secilën prej këtyre faqeve të dokumentit -- t'i tregoj secilën faqe të këtij dokumenti, Dëshmitarit. Në total janë gjashtë faqe. Faleminderit.

PY. Z. Kelly, pasi i pamë të gjitha faqet, ju nuk flisni shqip?

PË. Nuk flas shqip.

PY. Tani që patë faqet, ju keni konfirmuar se secila prej këtyre faqeve ishte, në fakt, është gjetur në laptopin e z. Smakaj?

PË. Po. Kam patur mundësinë ta shikoj, ta shqyrtoj dokumentin.

Z. HAFETZ: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, një sekondë, ju lutem.

Nuk kam pyetje të tjera, i nderuar Gjykatës. Faleminderit.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, z. Hafetz.

E ka radhën z. Misetic tani?

Z. MISETIC: [Përkthim] Po. A mund të vazhdoj.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po.

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic:

Z. MISETIC: [Përkthim]

PY. Mirëdita, z. Kelly.

PË. Mirëdita.
PY. Unë jam Luka Misetic. Përfaqësoj Hashim Thaçin dhe kam disa pyetje për ju sot. Do të përpiqem të bëj pushim, kur të jepni ju përgjigjet dhe do përpiqem që dhe unë të bëj -- t'ju jap kohë përkthyesve në pyetjet e mira që të përkthejnë.
Së pari, një pyetje kontekstuale, juve ju është kërkuar të nxirrni të dhëna nga telefonat celularë mobil të disa të akuzuarve, disa dëshmitarëve, përkatësisht. Z. Fadil Fazliu, Fahri Fazliu, z. Smakaj, z. Kilja, z. Mustafa, dhe z. Zyrapi; është e saktë?
PË. E saktë.
PY. E kuptoj që materiali bruto që ju keni përdorur kanë qenë pajisje mobile -- raporte të nxjerrjes së materialeve nga pajise mobile që janë krijuar nga IKH-ja, pra Instituti i Forensikës Kombëtar, nga këto telefona; është e saktë?
PË. E saktë.
PY. Z. Kellly, nxjerrjet që keni nga telefonat e ndryshëm të sekuestruar janë bërë duke përdorur një listë fjalësh kyçe, kërkuese, dhe terma përkatës për këtë; është e saktë?
PË. Po. IKH-ja ka bërë nxjerrjen që është kopje e të dhënave për secilën pajisje. Ata kanë dhënë këto nxjerrje ZPS-së, këto materiale të nxjerrura dhe këto materiale të nxjerrura pastaj janë analizuar dhe është bërë kërkim duke përdorur fjalë çelës apo fjalë kyçe.
PË. Në rregull.

Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Sekretare, do të doja që të shfaqim në ekran DHT1200405 deri në 00405. Është konfidencial dhe kjo për transmetim për publikun. E kemi transmetuar listën e materialeve që do të përdornim, nuk e di a është e disponueshme.

[Gjykatësi i Vetëm dhe Sekretarja e Gjykatës këshillohen]

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Na jepni një çast që të gjejmë listën e materialeve.

Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

Ndërkohë që paraqitet dokumenti ndoshta do të ishte mirë që të bëj disa pyetje të tjera në mënyrë të tillë që të kursejmë pak kohë, nëse më lejoni.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull. Mund të vazhdoni.

Z. MISETIC: [Përkthim]

PY. Z. Kelly, dëshiroj që të bëj disa pyetje plotësuese ndaj pyetjeve që ju bëri Prokurori drejt fundit të pyetjeve tuaja. Atëherë, ju besoj se i kujtoni pyetjet që kishin të bënin me një hartë të Google Maps për sa i takon telefonave të z. Smakaj dhe z. Zyrapi, për telefonat iPhone të tyre dhe ju thoni “vendndodhje domethënëse”. Kështu që a mund të na e shpjegoni pak këtë togfjalëshin çfarë do të thotë “vendndodhje domethënëse”?

PË. Kjo është një shprehje e Apple dhe një term që përdoret

nga Apple. Dhe kjo përdoret si shprehje për përvojën e përdoruesit.
PY. Pra, një vend me domethënie për juve, domethënë është një vend që Apple e identifikon si vend që përdoret kryesisht pajisja apo jo?
PË. Po.
PY. A e kam kuptuar drejt që ky vend, domethënë, vendi domethënës zbatohej si për z. Zyrapi dhe për z. Smakaj, domethënë, është e njëjta gjë për të dy telefonat smart?
PË. Po.
PY. A do të thotë kjo që i takon që z. Smakaj dhe z. Zyrapi e kanë vizituar shpesh restorantin Gizzi?
PË. Nuk është e nevojshme që të vizitosh disa herë ose ta vizatosh shpesh një vend në mënyrë të tillë që vendi të identifikohet si vend domethënës. Pra, mund të shkosh më pak herë, por qëndrimi aty të jetë më i gjatë, por duhet të shkosh më shumë sesa një herë.
PY. Pra, i takon që mund të arrijmë në përfundimin se të dy zotërinjtë, edhe në qoftë se kanë shkuar vetë ose në qoftë se kanë shkuar me njëri-tjetrin, i takon që kanë qëndruar në këtë vend për periudha të konsiderueshme kohe, apo jo?
PË. Po.
Z. MISETIC: [Përkthim] U gjet dokumenti?
GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po.
Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë, për procesverbal dhe një

herë i kërkoj Sekretares që të paraqesë në ekran dokumentin DHT -- është një dokument që nuk duhet të paraqitet për publikun, por ka numrin DHT102405 [Sipas përkthimit] deri në 120405

PY. Z. Kelly, ky është një email që i dërgohet Mbrojtjes nga ZPS-ja që mban datën 20 mars 2025, ZPS-ja thotë, "po ju japim protokollet e kontrollit ose termat e kontrollit për secilin prej telefonave të lëvizshëm sipas listës sipas rregullës 102(3)". Domethënë, ky është email që na ka dërguar ZPS-ja.

Z. MISETIC: [Përkthim] Ndërkohë që tani do i kërkoj Sekretares që të kalojmë tek Shtojca që mban numrin DHT 120046 [Sipas përkthimit] deri në 00411. Nuk duhet të paraqitet për publikun. Domethënë, kjo është shtojca e këtij emailit që sapo e pamë në ekran të dërguar prej ZPS-së.

PY. Ky dokument përfshin një listë të fjalëve kyçe që është përdorur nga ZPS-ja në mënyrë të tillë që të nxirren të dhënat e telefonave të sekuestruar sipas rregullës 102(3), apo jo, Dëshmitar?

PË. Po.

PY. A e keni parë këtë dokument më përpara?

PË. Po.

PY. Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është që të gjurmohej lidhja midis individëve përkatëse, pra, të dhënë në listën përkatëse dhe telefonatave të bëra, thirrjeve të bëra prej këtyre telefonave, apo jo?

PË. Po, janë thirrjet telefonike të cilat janë të dhëna me hollësi në seksionin I, në seksionin II, në fakt.
PY. Këto janë udhëzimet e dhëna prej jush?
PË. Po.
PY. Data e nxjerrjes së informacionit është kufizuar nga 1 janari 2023 deri në ditën e sekuestrimit të telefonave; a është e saktë kjo?
PË. Po.
Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, dëshiroj që të paraqes për pranim në prova gjyqësore faqet 00408 deri në 00409 të këtij dokumenti.
GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ka kundërshtime.
Z. HAFETZ: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës. Thjesht dua që të sigurohem që dokumenti është i plotë.
Z. MISETIC: [Përkthim] kërkojmë që të pranohet i gjithë dokumenti.
Z. HAFETZ: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.
GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Pranohet dokumenti.
SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës. Dokumenti me numër ERN DHT1200406 deri në 004011 do të marrë numrin e provës gjyqësore 1D00030, klasifikohet si konfidencial.
Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Tani dëshiroj që të paraqes për pranim në prova emailin që sapo pamë, që ka numrin DHT1200405 deri në 00405.

Z. HAFETZ: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Pranohet.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, dokumenti do të marrë numrin e provës 1D00031. Klasifikimi është konfidencial.

Z. MISETIC: [Përkthim] Ndërkohë që e kemi dokumentin në ekran do ju kërkoja që të kalonin tek faqja 00408 e të njëjtit dokument.

PY. Z. Kelly, a mund të konfirmoni që në seksionin II, kontrollet e përmendura në këtë dokument janë bërë, ndër të tjera, në telefonin e Fadil Fazliut, që është rreshti 8 [Sipas përkthimit]; telefonin e Fahri Fazliut në rreshtin b; telefonin e Smakajt, që është pika d; dhe telefonin tjetër që është tek faqja tjetër, telefoni i z. Kilaj. E konfirmoni këtë, apo jo?

PË. Nuk e konfirmoj sepse -- jo, ju kërkoj ndjesë, në fakt, e konfirmoj.

PY. Në qoftë se ka patur kontakte në listën e individëve në telefonat e analizuar, të dhënat do jenë nxjerrë prej jush apo nga dikush tjetër, analist tjetër i ZPS-së?

PË. Besoj që jam unë personi që i ka nxjerrë këto të dhëna.

PY. Domethënë, keni qenë ju personi që keni nxjerrë këto të dhëna, apo jo?

PY. Po.

PY. Tani dëshiroj të kaloj te nxjerrja e informacionit që ka

të bëjë me Fadil Fazliun dhe Rrustem Mustafën. Ju është kërkuar që të nxirrni të dhëna nga telefoni i Fadil Fazliut, dhe ndërkohë që keni kontrolluar telefonin e tij ju nuk keni identifikuar ndonjë komunikim midis Fadil Fazliut dhe z. Mustafa, apo jo?
PË. Po, është e saktë.
PY. Tani le të kalojmë tek Fahri Fazliu dhe Rrustem Mustafa. Një prej detyrave tuaja ishte që të nxirrnit të dhëna përkatëse që ishin në telefonin e z. Mustafa dhe që e lidhnin z. Mustafa me telefonin e z. Fahri Fazliu; a është e saktë kjo?
PË. Po.
Z. MISETIC: [Përkthim] I kërkoj Sekretares të paraqesë në ekran dokumentin SPOE00369419 deri në 00370343 RED në faqen SPOE00369419. Edhe ky dokument nuk duhet të paraqitet për publikun.
PY. Ju lutem shikoni pjesën e parë të faqes, përmbledhjen. A e keni parë këtë dokument më përpara, Dëshmitar?
PË. Kohët e fundit kam marrë kopje të një prej parashtrimeve të rezultateve të dokumentit 123 [Sipas përkthimit]. Nuk mund të them që ky është një dokument që e kam marrë.
PY. Kush e ka përgatitur këtë dokument? Kush i ka organizuar këto të dhëna që përmbahen këtu?
PË. Nuk e di.
PY. A e dini si ka përfunduar ky dokument tek ZPS-ja?

PË. Jo, nuk ka ardhur tek ZPS-ja. Unë i kam bërë kontrollet dhe unë ia kam dhënë rezultatet e kontrolleve ZPS-së. Dhe më pas kam qenë i përfshirë në proces.

PY. Mund të shohim një numër prove tek faqja e parë. A e shikoni në fund fare të përmbledhjes?

PË. Po, e shoh.

PY. Kjo përkon me telefonin e Rrustem Mustafës, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

PË. Nuk i mbaj mend përmendësh të gjithë numrat e provave të ZPS-së, por në qoftë se ju thoni kështu nuk kam arsye për t'u mos pajtuar.

PY. Po. Për procesverbal, kjo specifikohet në shënimin zyrtar në faqen 129373 deri në 129380, në faqen 129376 konkretisht. Nuk e di në qoftë se keni ndonjë kopje të shënimeve apo jo?

PË. Jo, vetëm ekranin kam.

PY. Fakti që numri i provave dhe numri i telefonit të z. Mustafa përkojnë me njëri-tjetrin, a do të thotë kjo që këto të dhëna kanë të bëjnë me informacionin ose të dhënat e nxjerra nga numri i z. Mustafa?

PË. Po.

PY. A mund të na thoni -- ose ta them ndryshe. Ta shohim të gjithë raportin - në qoftë se është e nevojshme - a mund të na thoni se çfarë lloj të dhënash janë nxjerrë nga ky telefon? Domethënë, çfarë lloj të dhënash janë këto të dhëna që shikojmë të pasqyruara në këtë raport, mund të na i shpjegoni,

Dëshmitar?

PË. Po, e shoh të plotë raportin. Sipas kësaj faqeje, përmbajtja e këtij dokumenti përfshin thirrje telefonike, biseda, domethënë, kemi disa aplikacione që përdoren për shkëmbim bisedash, për shembull, një prej tyre është Messenger, Facebook Messenger, shohim gjithashtu edhe përdorimin e WhatsApp, Viber, shikojmë informacionin e kontaktit, shohim edhe historikun internetit edhe dosjet e të dhënave.

Z. MISETIC: [Përkthim] Të vazhdojmë pak më lartë faqes.

PY. Tek pjesa e përmbledhjes thuhet "Filtri i raportit të përdorur". A do të thotë kjo që kjo është periudha e kohës për të cilën keni nxjerrë të dhënat nga telefoni?

PË. Nga raporti i lexuesit, po.

PY. Ça domethënë "raporti i lexuesit", ma shpjegon dot?

PË. Po, sigurisht. Raporti i lexuesit është përmbajtja e nxjerrjes së informacionit nga telefonat që ka prodhuar IKH-ja.

PY. Domethënë, i gjithë informacioni që kemi këtu është informacion që është nxjerrë nga data 1 janar 2023 deri në më 12 shtator 2023?

PË. Duke përfshirë dhe dokumente të cilat nuk e kanë këtë metadatë ose, për shembull, që nuk tregohet se kur mund të jetë dërguar mesazhi, në çfarë vendi, pra, teorikisht mund të ketë edhe gjëra të tjera që shkojnë përtej kësaj date. Dhe

kërkojnë konfirmim tjetër të mëtejshëm për të identifikuar në qoftë se ato kanë lidhje me këtë periudhë kohe apo jo.

PY. Atëherë ky është një raport i cili është gjeneruar mbështetur në periudhën kohore të aplikuar dhe mbështetur në fjalët kyçe të përdorura mbi bazën e rregullës 102(3), apo jo?

PË. Nuk kam përgjigje në këtë. Nuk e di. Nuk kam qenë pjesë e këtij procesi.

PY. A mund të na thoni se çfarë kriteresh keni përdorur ju?

PË. Kam përdorur fjalët kyçe, kam parë të gjitha dokumentet përpara që kam pasur në raportet e nxjerrjes dhe nuk e di se çfarë ka ndodhur më tej.

PY. Po kur keni nxjerrë të dhëna ju çfarë të dhënash keni nxjerrë mbi çfarë kriteresh?

PË. Kam përdorur termat e kontrollit, kur kam pas rezultate mbas përdorimit, atëherë këtë informacion e kam nxjerrë. Pra, kjo ishte faza e parë dhe ZPS-së i kam thënë të gjitha përgjigjet, të gjithë dokument që kam marrë pasi kam përdorur termat e kontrollit.

PY. Kur flasim për "termat e kontrollit" e keni fjalën për termat e kontrollit që diskutuam pak më përpara, domethënë, këto fjalët kyçe, për këtë e keni fjalën, apo jo?

PË. Janë emrat, numra telefoni, ID të Facebook ose llogaritë Facebook, domethënë, për çdo individ. Këto janë termat kyç ose fjalët kyçe.

Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, Sekretare, kaloje

dokumentin që kemi përpara në faqen SPOE00369428, dëshiroj që të paraqisni në ekran dhe përkthimin e këtij dokument në anglisht që mban numrin DHT1200397 deri në 00398, konkretisht faqen 00397.
PY. Z. Kelly, këto mesazhe janë nxjerrë nga telefoni i z. Mustafa, apo jo?
PË. Jemi akoma tek i njëjti dokument që më treguat më herët?
PY. Po, jemi brenda të njëjtit dokument, është i njëjti dokument.
PË. Po, duket kështu.
PY. Këto janë komunikime në Facebook midis Fahri Fazliut dhe z. Mustafa, apo jo?
PË. Po.
PY. Shohim dy mesazhe që janë dërguar nga Fahri Fazliu në prill 2023, apo jo, 16 prill 2023, është e saktë kjo?
PË. Shoh një mesazh më 16 prill.
Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë pak më poshtë në ekran.
DËSHMITARI: [Përkthim] Po e shikoj dhe mesazhin e dytë.
Z. MISETIC: [Përkthim]
PY. Në qoftë se shohim këtë kuadratin që është mbi tekstin e mesazhit shohim kohën e fillimit që është 8 maj dhe çfarë është kjo, domethënë, është 8 maj 2020. A mund të na e thoni çfarë është kjo?
PË. Është koha, fillimi i kësaj bisede, domethënë, kur ka filluar kjo bisedë.

PY. Pra, i takon që ata kanë qenë në këtë bisedë që prej 8 majit 2020, apo jo, është e saktë kjo, Dëshmitar?
PË. Po.
Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër SPOE00369429.
PY. Këtu shohim që biseda vazhdon. A konfirmoni që këto janë biseda midis Fahri Fazliut dhe z. Mustafa që mbajnë datën 17 prill 2023, pra, janë dërguar përmes Messenger të Facebook?
PË. Po.
Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Sekretare, do ju kërkoja tani të shfaqnit në ekran dokumentin SPOE00370103, në faqen 685 në PDF, në versionin në anglisht dhe përkthimin përkatës në shqip me numër DHT1200397 deri në 00399, që besoj që faqja përkuese është DHT1200398.
PY. Z. Kelly, së pari, në fillim të faqes thuhet: Koha e fillimit, start time 4 maj 2022. Na e shpjego pak ju lutem se çfarë do të thotë kjo?
PË. Si më herët sikurse ua shpjegova, domethënë, është koha kur ka ndodhur kjo bisedë konkrete. Domethënë, koha kur ka ndodhur është data 4 maj 2022.
PY. Shohim që ka tre mesazhe të shkëmbyera ndërmjet z. Fahri Fazliu dhe Mustafës përmes WhatsUpp me datën 28 prill 2023. A është e saktë kjo, Dëshmitar?
PË. Ju lutem, a mund ta shoh të plotë faqen?
PY. Patjetër.

PË. Po, i shoh, i shoh këto tre mesazhe.
PY. Dhe data e tyre është 24 prill 2023, apo jo?
PË. Po.
Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja tjetër, SPOE0037014.
PY. Këto janë komunikime shtesë midis Fahri Fazliu dhe z. Mustafa në Facebook, apo jo?
PË. Po.
PY. Shohim që ka edhe një telefonatë të humbur, një thirrje të humbur më 3 maj 2023 dhe kemi disa mesazhe më datën 4 maj 2023?
PË. Nuk e shikoj dot datën në fund të faqes, në qoftë se mund ta kaloni pak më në fund faqen. Po i shoh tani. Në rregull.
Z. MISETIC: [Përkthim] Tani do të kaloj tek faqja tjetër, që është SPOE00370105.
PY. A është e saktë që biseda midis Fahri Fazliut dhe Mustafës vazhdon edhe në këtë faqe që është në datë 4 maj 2023? Në qoftë se doni mund të kalojmë edhe më poshtë në faqe që ta shikoni të plotë.
PË. Nuk e shikoj të tërë faqen, por kjo është e saktë.
Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër SPOE00370106.
PY. A është e saktë që Fahri Fazliu i ka dërguar disa bashkëlidhje, dokumente bashkëlidhur z. Mustafa më 5 maj 2023 ose rreth kësaj date?

PË. Shikoj dy fotografi që janë bashkëlidhur që mund të shihen në ekran dhe një të tretë. Po, tre. Po, kjo është data 5 maj.

Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoj Sekretares të kalojmë tani tek faqja tjetër, që është faqja SPOE00370107.

PY. Këtu tregohen tri mesazhe të dërguara më 26 qershor 2023, a është e saktë kjo, në qoftë se doni mund të shikoni të gjithë faqen.

Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretares ta tregojë të gjithë faqen.

DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

Z. MISETIC: [Përkthim]

PY. Z. Kelly, në deklaratën tuaj sipas rregullës 154, që është pranuar në prova gjyqësore tani, ka numër ERN 129373 deri në 129380, ju keni krijuar një raport Cellebrite të mesazheve midis z. Mustafa, Dëshmitarit 1 dhe Fahri Fazliut për periudhën nga 7 qershori 2023 deri në 18 korrik 2023 nga telefoni celular i z. Mustafa të sekuestruar më 12 shtator 2023. Në të përfshihen mesazhe të dërguara më datë 26 qershor, 239 qershor dhe 3 korrik 2023.

Megjithatë, sikurse e pamë z. Mustafa dhe z. Fahri Fazliu kanë qenë në kontakt me njëri-tjetrin muaj e vite më përpara se 2023 dhe kanë shkëmbyer në mënyrë të rregullt mesazhe dhe bashkëbisedime me njëri-tjetrin, a është e saktë kjo?

PË. Po.

Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj që të pranohen në prova gjyqësore shtatë faqet e dokumentit që sapo pamë që ka numrin SPOE0036149 deri në 00370234 RED, që ia tregova dëshmitarit përpara një çasti. Konkretisht kërkoj që të pranohen në prova faqet SPOE00369428, SPOE369429 dhe SPOE00370103 deri në SPOE0037017 dhe përkthimet përkuese në anglisht nga faqja 00397 deri në 00397.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ka ndonjë kundërshtim?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Pranohen në prova, nuk e di si duhet të jetë klasifikimi konfidencial apo jo?

Z. MISETIC: [Përkthim] Varet nga Prokuroria.

Z. HAFETZ: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, mund të jetë publik, megjithatë na duhet të rishikojmë numrat njëherë përpara sesa të vendosim për klasifikimin.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Le ta pranojmë për momentin si provë materiale konfidenciale.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faqet që u përmendën nga avokati do të marrin numrin e provës 1D0032, së bashku me përkthimet në anglisht dhe klasifikimi aktualisht është konfidencial.

Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Z. Kelly, tani dëshiroj që të flasim lidhur me nxjerrjen e informacionit që ju keni bërë lidhur me komunikimin midis z. Smakaj dhe dëshmitarëve të ZPS-së. Si fillim do e fillojmë me

z. Smakaj dhe Bislim Zyrapin.

Z. MISETIC: [Përkthim] I kërkoj Sekretares të paraqesë në ekran dokumentin SPOE0040010997 deri në 40012496 RED në faqen SPOE40010997. Edhe ky dokument nuk duhet paraqitur për publikun.

PY. Z. Kelly, nuk besoj se e dini kush e ka krijuar, kush e ka gjeneruar këtë raport, apo jo?

PË. Jo, nuk e di.

PY. Mund të shohim tek faqja e parë që numri i çështjes është Smakaj. E shikoni këtu në fund?

PË. Po.

PY. Dhe mund ta shikoni edhe numrin e provës. E shikoni numrin, Dëshmitar?

PË. Po, e shoh.

PY. Në Shënimin Zyrtar me numër 129379 deri në 129380 në faqen 129376, ju e identifikoni këtë numër, pra, numrin e provës si identike me numrin e telefonit celular iPhone të Bashkim Smakajt. A keni ndonjë arsye për ta kundërshtuar këtë?

PË. Jo.

PY. Kjo do të thotë që të dhënat e përfshira në këtë dokument janë marrë nga telefoni i z. Smakaj, apo jo?

PË. Po.

Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të kalojmë më poshtë në dokument si fillim.

PY. Sa i takon përmbajtjes së nxjerrë prej këtij telefoni

është e ngjashme siç diskutuam pak herët, apo jo, përmbajtja është e ngjashme, apo jo?
PË. Po.
PY. Të kalojmë përsëri në fillim të faqes, pra, filtri për raportin e përdorur është i njëjti, domethënë, nga 1 janar 2023 deri më 30 tetor 2023, përfshirë këtu edhe dokumente dhe shkëmbime të cilat nuk kanë kohë, nuk kanë stampën e kohës, apo jo?
PË. Po, është e saktë.
Z. MISETIC: [Përkthim] I kërkoj Sekretares të paraqesë në ekran faqen SPOE40011760 që është faqja 764 në PDF dhe të paraqitet gjithashtu edhe përkthimi në anglisht i këtij dokumenti që ka numrin DHT1200400 deri në 00401 në faqen 400.
Tregoni fillimin e faqes, ju lutem.
PY. Z. Kelly, nga tabela që kemi në fillim të faqes e kuptojmë që mesazhet e shkëmbyera midis Bislim Zyrapit dhe Bashkim Smakajt janë bërë përmes platformës Viber, apo jo?
PË. Po.
PY. Përpara kohës së fillimit të shkëmbimeve të bisedave kemi kohën e nisjes së bisedave që është data 17 mars 2020. A do të thotë kjo që bisedat kanë filluar përpara vitit 2023?
PË. Po.
PY. Këtu mund të shikojmë mesazhe që janë dërguar në data të ndryshme ndërmjet këtyre dy personave, për shembull, shohim një shkëmbim që ka ndodhur më 1 mars 2023, 31 mars 2023, 2 maj

2023 dhe 6 qershor 2021, a është e saktë kjo, Dëshmitar?
PË. Po.
Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Sekretare, të kalojmë tek faqja tjetër, SPOE40011761.
PY. Z. Kelly, ky është vazhdimi i të njëjtës bisede në Viber midis z. Smakaj dhe z. Zyrapi më datë 7 qershor 2023. A është e saktë kjo?
PË. Po. Katër mesazhet e para kanë datën 6 qershor.
Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Sekretare, do ju lutesha të paraqisnit tani në ekran SPOE40011078, që është faqja 82 e versionit në PDF.
Shohim fundin e faqes, më duket jo. Më duket 078 është faqja që po kërkoj. Kjo.
PY. Shohim në fund të faqes, këtu thuhet "Mesazhe native". E shihni këtë poshtë "burimit"? A mund të na shpjegoni çfarë janë këto mesazhe native?
PË. Po. Këto janë mesazhe që janë dërguar dhe janë marrë duke përdorur aplikacionin e mesazheve që e ka telefonat iPhone, kanë një aplikacion telefonat iPhone që përdoret për të shkëmbyer mesazhe.
PY. Për kuriozitet nga ana ime, a mund të quhet mesazh *native* në qoftë se shkëmbehet një mesazh mes një iPhone dhe jo iPhone?
PË. Po. Dhe në këtë rast quhet mesazh *native*.
PY. Tani data këtu thotë 17 mars 2020. Supozojmë që kjo është

data e fillimit kur ka filluar të shkëmbejë mesazhe z. Smakaj dhe z. Zyrapi, apo jo?
PË. Po. Është data kur është shkëmbyer mesazhi i parë.
Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër të materialit që përfundon me 079, ju lutem.
PY. Këtu shohin disa mesazhe. Këto mesazhe janë shkëmbyer mes z. Smakaj dhe z. Zyrapi më 28 qershor 2023, iMessages?
PË. Po.
PY. Sa i takon komunikimit që është bërë këtu, ne shohim që urojnë njëri-tjetrit, i urojnë Bajramin njëri-tjetrit, e kuptojmë drejt?
PË. Unë nuk flas shqip, po besoj se po.
PY. Po fjalën *Eid* e njihni besoj, Bajram?
PË. Po.
Z. MISETIC: [Përkthim] Kthehemi tek faqja që mbaron me 761, është komunikim në Viber mes z. Smakaj dhe z. Zyrapi.
PY. Shohim një mesazh 29 qershor 2023 këtu që është përkthyer si "Gëzuar Bajramin ... Bislo. Mos ke me dal në Prishtinë sot?". E shihni mesazhin e datës 29 qershor?
PË. Po, e shoh, e shoh mesazhin. Po.
PY. Duke mbajtur parasysh kemi kaluar nga mesazhet iMessages në Viber, a pajtoheni ju me mua se z. Smakaj dhe z. Zyrapi kanë komunikuar vazhdimisht me njëri-tjetrin duke përdorur aplikacione të ndryshme?
PË. Pajtohem me këtë propozim. Po.

Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të shohim faqen SPOE40011048, ju lutem.

PY. Po shohim mesazhe në Facebook mes të dy personave të sipërcituar, saktë?

PË. Po.

PY. Dhe data e fillimit këtu tregon që bisedat në këtë platformë kanë filluar më 29 qershor 2023, kjo ka qenë biseda e parë, apo jo?

PË. Po.

PY. Mesazhi i parë në këtë faqe mban datën 29 qershor 2023 dhe mesazhet e tjera 30 qershor dhe 1 korrik të 2023, saktë?

PË. Po.

Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të kthehemi në faqen SPOE40011761 dhe përkthimi në anglisht, DHT1200400 deri në 00401 në faqen 00401, ky është komunikim në Viber midis z. Smakaj dhe z. Zyrapi.

PY. Tani shohim që janë dërguar dy mesazhe më 9 korrik 2023, saktë?

PË. Po.

PY. "Urime Bislo. Dhe shumë të tjera me shëndet dhe familje."

Dhe përgjigja është:

"Flm shoku."

Shohim prapë që është çuar një mesazh tjetër më datën 1 gusht 2023 nga z. Smakaj në orën 8:23. Dhe në këtë mesazh shkruhet:

"Përshëndetje, Bislo. Si je?"

Saktë?

PË. Po.

PY. Të kalojmë në faqen tjetër SPOE40011762 dhe në këtë rast kemi komunikim përmes Viber. Pak më vonë po atë ditë janë shkëmbyer prapë mesazhe nga z. Smakaj drejtuar z. Zyrapi në orën 10:39, saktë?

PË. Po.

PY. Këtu i thotë:

"Mbrena jam qetu ku pihet duhani."

Saktë? Kështu?

Shkojmë më poshtë?

PË. Jo, në rregull. E kuptova, e kuptova pyetjen. Thjesht po bëj krahasimin e një dy të dhënave këtu. Më jepni një çast? Ashtu është pra.

PY. Mesazhi i fundit është 31 gusht 2023 në këtë faqe dhe është pjesë e mesazheve që keni nxjerrë ju dhe i keni përgatitur për ZPS-në, saktë?

PË. Shkojmë pak më lart, ju lutem, në faqe? Po, saktë.

PY. Z. Kelly, a është e vërtetë që mesazhet që keni nxjerrë ju me kërkesë të ZPS-së nga telefoni i z. Smakaj janë thjesht një pjesë e komunikimeve që ka pasur z. Smakaj me z. Zyrapi?

PË. Po.

Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj pranimin e faqeve SPOE40011048, SPOE40011078, SPOE40011079,

SPOE4001760, SPOE40011761 dhe faqen që përfundon me 62 dhe përkthimet përkuese, DHT1200400-00401.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ka kundërshtime?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Jo, aspak. Dhe sa i takon konfidencialitetit, e kuptojmë që ka pasur shoqëri për një kohë të gjatë mes këtyre dy personave. Por në qoftë se z. Smakaj s'e ka problem që të bëhen publike të dhënat që lidhen me telefonin e tij, atëherë nuk ka asnjë problem për ne, nuk ka problem për ne.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Misetic, ju doni që të jetë dokument publik apo jo?

Z. MISETIC: [Përkthim] Unë preferoj për dokumente publike, në qoftë se është e mundur le të redaktojmë numrin e telefonit, ta fshehim dhe pjesa tjetër e dokumentit letë jetë publik, nuk ka problem për mua. Heqim vetëm numrin e telefonit.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Rees, mund të thoni diçka ju?

Z. REES: [Përkthim] Nuk kam unë problem në lidhje me këtë material, po duhet të fshihen të dhënat e personit.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Atëherë këtë dokument do ta pranojmë për momentin si dokument konfidencial, sugjeroj që ta rishqyrtoj më pas, nëse mund ta pranojmë të redaktuar, po me kërkesën tuaj.

Z. YOUNG: [Përkthim] A mund të them unë diçka, ju lutem.

Pajtohem me propozimin tuaj që në lidhje dhe me telefonin e z. Fahri Fazliu të redaktohen të dhënat personale dhe numrat e telefonit të z. Fahri Fazliu. Faleminderit.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Pa problem. Atëherë po e pranojmë dokumentin, por si konfidencial për momentin.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit atëherë. Faqet e renditura prej avokatit dhe përkthimet përkatëse do të marrin numrin e provës 1D00033 dhe klasifikimi është konfidencial. Faleminderit.

Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Z. Kelly, kam dhe një aspekt tjetër sa i takon komunikimit mes z. Smakaj dhe z. Zyrapi, dua që të shikojmë të dhënat e aplikacionit Cellebrite për z. Zyrapi.

Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë do të doja që të vendosej në ekran materiali SPOE00374260 deri në 0037437 RED dhe më konkretisht të shohim faqen që përfundon me 260. Materiali nuk është publik.

PY. Këtu shohim një raport Cellebrite janë të dhëna tani të telefonit të z. Zyrapi, apo jo?

PË. Kështu duket.

PY. Shohim filtrin e raportit dhe datat fillojnë nga 1 janari 2023, përfshirë 1 nëntorin 2023, përfshirë materialet që kanë vula kohore?

PË. Po.

PY. Në rregull.

Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë le të shohim tani në ekran materialin SPOE00374268.

PY. Shkojmë në fund të faqes, këto janë mesazhe në Messenger të Facebook dhe përmenden këtu emri Bashkim Smakaj dhe z. Zyrapi. Pra, a janë këto komunikime që kanë pasur në aplikacionin Messenger të Facebook?

PË. Po.

Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër, tek faqja që përfundon me 269, ju lutem, përbri dhe anglishten, DHT1200404-00404.

PY. Këtu shohim dy mesazhe të 29 qershorit 2023, një në orën 13:58 dhe një të 13:59, komunikim mes z. Smakaj dhe z. Zyrapi, saktë?

PË. Dua ta shoh në përkthim. Po, i shoh. I shoh, po.

PY. E para, mesazhi i parë është dërguar nga z. Zyrapi dhe ai ka thënë:

"Flm Bashko, nesër kam me pru vajzën në provim në 12.00."

Dhe mesazhi i dytë:

"Ani, super, pimë kafe."

Saktë?

PË. Po.

PY. Tani e kemi parë që ka pasur komunikim mes z. Smakaj dhe z. Zyrapi të nxjerra nga telefoni i z. Smakaj. Por këto mesazhe nuk i kemi parë në telefonin e z. Smakaj, apo jo?

PË. Po nuk më kujtohen të gjitha mesazhet që kam parë në

provat e mëparshme.
PY. Atëherë çfarë shpjegimi keni ju, duke supozuar që unë kam të drejtë, atëherë pse këto mesazhe gjenden në Messenger e z. Zyrapi por nuk gjenden në atë të z. Smakaj?
PË. Po, gjasat janë që dikush t'i ketë fshirë.
PY. Po a e verifikuat ju këtë?
PË. Nuk më kujtohet nëse e kam verifikuar, ka mundësi.
PY. A e verifikuat dhe, nëse e verifikuar ju këtë, a e vutë në dijeni Prokurorinë që mesazhet janë fshirë nga z. Smakaj?
PË. Nëse do e kisha bërë, po.

Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj pranimin e faqes SPOE00374269 të kësaj faqe dhe përkthimin e materialit që ka numrin DHT1200404-00404.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ka kundërshtime?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Jo, vetëm redaktimet të kemi parasysh.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull. E pranojmë si dokument konfidencial.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Kjo faqe dhe përkthimi në anglisht do të marrë numrin e provës 1D00034 dhe klasifikimi është konfidencial. Faleminderit.

Z. MISETIC: [Përkthim]
PY. Z. Kelly, dua t'i kthehemi telefonit të z. Smakaj që diskutuam dhe më herët, më konkretisht bëhet fjalë për materialin me numrin SPOE40010997 dhe 400196, tani dua të

fokusohemi dhe tek komunikimi që ka pasur z. Smakaj me z. Rrustem Mustafa.

Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem shkojmë në faqen SPOE4001176755, që është faqja 759 në PDF dhe përkthimi DHT1200402 deri në 00403.

PY. Këtu janë komunikime mes z. Smakaj dhe z. Mustafa, komunikimet janë në aplikacionin Viber, saktë?

PË. Jo, nuk besoj. Unë e di numrin e telefonit të z. Mustafa dhe nuk është ky numri i telefonit. Mbase është faqja e gabuar, nuk e di.

Po telefoni këtu nuk është i saktë.

Z. MISETIC: [Përkthim] I drejtohem Sekretarisë, a po shohim faqen 11755 në ekran?

PY. Shohim kutinë lart, a pajtoheni atëherë që ky është komunikim në Viber mes z. Smakaj dhe z. Mustafa?

PË. Shoh numrin e telefonit. Po, po, e shoh. Po.

PY. Edhe një herë data e fillimit është 27 tetor 2020, që sipas jush, kjo është data kur ka filluar komunikimi?

PË. Është mesazhi i parë në këtë aplikacion, po.

PY. Mesazhi i parë mban datën 12 prill 2023, saktë?

PË. Në provë, po. Në provë, po.

PY. Dhe ka mesazhe të 3 korrikut 2023 edhe vijojmë më tej mesazhet dhe këtu përmendet lokali Route 66, saktë?

PË. Po.

Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqen SPOE40011756, ju

lutem. Këto më shumë mesazhe në Viber mes z. Smakaj dhe z. Mustafa, saktë?
PË. Po.
PY. Data 7 gusht 2023?
PË. Shoh që mesazhet e fundit, po. Po, i shoh. Po, po, i shoh. Po. 7 gushti. Po.
Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër.
PY. Vazhdon biseda mes të njëjtëve persona? Pra, në këtë rast mesazhet vijojnë, janë të datës midis datës 7 gusht dhe 5 shtator 2023.
PË. Po, mesazhet janë në fund fare, janë të datës 5 shtator 2023.
Z. MISETIC: [Përkthim] Tani të shikojmë materialin tjetër që përfundon me 758, ju lutem.
PY. A mund të na konfirmoni që mesazhi i fundit në këtë faqe po ashtu ka datën 5 shtator 2023?
PË. Po.
PY. Duke mbajtur parasysh analizën që keni bërë, a pajtoheni ju me mua që këta dy persona kanë pasur kontakte të vazhdueshme të rregullta me njëri-tjetrin?
PË. Komunikimi i tyre ka filluar kohë përpara analizës të mesazheve që kemi bërë ne, kështu që propozimi juaj është i drejtë.
Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj pranimin e faqeve SPOE4001175 deri në SPOE40011758 si dhe

përkthimin e tyre që mbajnë numrin DHT1200402 dhe 00403.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Kundërshtime nga Prokuroria?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Pranohet si dokument konfidencial.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Këto katër faqe mund t'i bashkëngjiten provës që pranuam pak më herët dhe që kishe numrin e provës 1D00033 se janë pjesë e të njëjtit dokument. Faleminderit.

Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, unë kam një temë tjetër. Shpresoj që të përfundoj.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në 3.55 duhet patjetër që ta mbyllim.

Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të shikojë dhe një herë numrin e anglishtes sepse më kanë thënë që numri i përkthimit është tjetër.

PY. Folëm pak për gjeolokacionet e iPhone në fillim të pyetjeve të mia, pra, vendndodhjen gjeografike. Ju dhatë pamje nga ajri të Google Earth, apo jo?
PË. Po.
PY. Treguat restorantin Route 66 dhe adresën e pretenduar të Fadil Fazliut?
PË. Kam dhënë numrin e gabuar më herët. Nëse po flasim për këtë provë materiale në këtë rast kam përdorur Google Maps, që

është koha që nevojitet nga një drejtim për të shkuar tek Route 66.

PY. Dhe ju konfirmuat se nga shtëpia e z. Fazliu duhen gjashtë minuta për të shkuar tek Route 66?

PË. Përdora Google Maps.

PY. Nuk ka problem nëse diskutohen dy minuta më pak apo më shumë këtu, por ju thoni me përafërsi kjo ka qenë koha që nevojitet nga shtëpia e z. Fazliu deri tek Route 66?

PË. Po.

PY. A ju është kërkuar të gjeni ku jeton Rrustem Mustafa?

PË. Në përgjithësi emri i rrugës ka qenë tek provat materiale. Nuk e kam provën materiale përballë tani, po nuk mund t'ua them me siguri.

PY. A përdorët Google Maps prapë në këtë rast?

PË. Nuk e kam të saktë tani, po mund të them që për afërsi janë afër.

PY. Pra, ju po thoni që z. Mustafa, z. Fazliu dhe ky restoranti Route 66 janë në të njëjtën zonë?

PË. Po.

PY. Sa herë janë takuar z. Fazliu dhe z. Mustafa tek Route 66 për të pirë kafe në lagjen e tyre?

PË. Nuk e di.

PY. Ua kërkoi ju njeri ta verifikonit këtë?

PË. Nuk ma kërkoi asnjëri ta verifikoja këtë.

PY. A mund ta kishit zbuluar ju këtë përmes analizës së

telefonave?
PË. Nuk e besoj.
PY. Përmes iPhone nëse zë Fazliu dhe z. Mustafa jetojnë afër njeri-tjetrit dhe afër Route 66, a mund të verifikohej përmes iPhone vendndodhja e tyre dhe sa herë janë takuar?
PË. Për kë po flasim?
PY. Për Fadil Fazliun?
PË. Fadil Fazliu kishte Android nuk kishte iPhone dhe nuk kishte shumë të dhëna në telefon.
PY. Po thoni që Android nuk i ka këto të dhëna?
PË. Dhe telefonat Android mbajnë të dhëna për vendndodhjen, por nuk më kujtohet të kem kërkuar këto të dhëna në këtë Android specifik.
PY. Le të flasim për Smakaj dhe për Zyrapin, ju keni gjetur vendndodhjen, na treguat një foto ajrore të restorantit Gizzi që e keni nxjerrë nga Google Maps?
PË. Po.
PY. Dhe ua tregoi dhe Prokurori gjatë pyetjeve vendndodhjen e telefonit të z. Zyrapi dhe të z. Smakaj në raport me restorantin Gizzi, kështu?
PË. Po.
PY. A u është kërkuar ju të gjeni ku është shtëpia e z. Smakaj, ta gjenit vendndodhjen e shtëpisë së z. Smakaj?
PË. Nuk më kujtohet nëse më është kërkuar kjo gjë, por unë e kam bërë.

PY. Pra, e keni bërë?
PË. E di ku është.
PY. A jeton dhe ai në atë zonë?
PË. Më kujtohet që ka qenë disa kilometra larg, por nuk e kam shumë të saktë.
PY. Ka prova dhe, palët pajtohen, se z. Zyrapi ka thënë se shkonte në Universitetin e Prishtinës çdo të hënë ose të martë për të lënë dikë dhe kthehej të premten për ta marrë këtë person. A bëtë ndonjë verifikim ju për të kuptuar sa larg ishte universiteti nga restorant Gizzi?
PË. Po e bëra. Dhe janë pak kilometra larg. Po janë relativisht afër me njëri-tjetrin.
PY. Mund t'ua tregoj unë në Google Maps.
Z. MISETIC: [Përkthim] DHT12450 deri në DHT00450. Më falni, unë numrin ua dhashë gabim. Edhe një herë. Bëhet fjalë për materialin 1200453 DHT00453.
PY. Është rreth 12 minuta me këmbë, e shihni. Rreth 12 minuta me këmbë thotë, rreth 750 metra.
PË. E shoh.
PY. Pra, nuk është disa kilometra. Është më pak se një kilometër.
PË. Po nuk e kisha kujtesën aq të mirë sa ç'mendova.
PY. Thamë më herët se duket se këta persona janë në të njëjtën zonë ku është dhe restorant Gizzi, herë pas here në bazë të të dhënave që keni nxjerrë ju?

PË. Kështu i regjistron iPhone të dhënat për lokacionin.

PY. Po sa herë takoheshin z. Smakaj me z. Zyrapi për kafe?

PË. Nuk funksionon kështu. Ata mund të shkonin dhe vetëm atje tek ai vend dhe vendndodhja regjistrohet si vendndodhje e rëndësishme në iPhone.

Po atë ditë është përmendur si vendndodhje e rëndësishme për të dyja palët.

PY. Po si e identifikuat datën ju?

PË. Duke piketuar të dhënat për lokacionin në të dy telefonat dhe duke e parë oraret nëse përkonin.

PY. Po mirë e keni bërë ju këtë dhe për herë të tjera, mos ka ndodhur që të kenë qenë edhe ata dhe herë të tjera në restorantin Gizzi, a mos takoheshin çdo të hënë, çdo të premte në restorantin Gizzi për kafe?

PË. Kjo është hera e parë që të dy aparatet regjistrohen në të njëjtin lokacion. Është e vetmja herë që më kujtohet t'i kem parë të dyja pajisjet pranë njëra-tjetrës në të njëjtin vend dhe në të njëjtin orar.

PY. Juve ju kërkuan që të bënit verifikimin nga 1 janari 2023 dhe deri diku nga fundi i tetorit dhe ju po thoni që kjo është e vetmja herë që të dy telefonat kanë qenë bashkë?

PË. Jo, ka qenë që nga shtatori deri në momentin e sekuestrimit.

PY. I bie në më pak se dy muaj, pra, e keni bërë këtë analizë dhe nuk e patë as verën as periudhën pararendëse, apo jo?

PË. Jo, nuk e kam parë.

Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj pranimin e kësaj prove që është harta në Google dhe që ka numrin DHT1200453-00453.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] A ka kundërshtime?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull. Pranohet dhe është dokument publik.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Ky do të marrë numrin e provës 1D0035 dhe do të riklasifikohet si publik.

Z. MISETIC: [Përkthim]

PY. Z. Kelly, faleminderit që u përgjigjët pyetjeve. Kaq pyetje kisha unë për ju. Faleminderit.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, z. Misetic.

Në rregull. Po e mbylli për sot. Z. Kelly, jeni ende nën betim çka do të thotë se nuk duhet të diskutoni dëshminë tuaj me askënd.

ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Unë nuk e di nëse kanë pyetje palët e tjera.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Znj. Menegon, kemi një aspekt që duhet ta trajtojmë, nuk ka më kohë për sot. Nuk mund të vazhdojmë me kundërpyetjet e këtij dëshmitari për sot. Do të vazhdojmë nesër.

Z. REES: [Përkthim] Unë kam pyetje, shkurt po kam pyetje,

kam disa pyetje.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit. Do të vazhdojmë nesër paradite.

Z. Kelly, ju lutem mos diskutoni me askënd dëshminë tuaj jashtë sallës së gjyqit, do të shihemi nesër në orën 9.30.

DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Young, kishit diçka për të trajtuar në seancë të mbyllur?

Z. YOUNG: [Përkthim] Po. Në seancë të mbyllur. Është e shkurtër, po mund ta bëjmë dhe nesër në qoftë se e gjykoni që është më e përshtatshme.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Kalojmë në seancë private.

Z. YOUNG: [Përkthim] Faleminderit. I nderuar Gjykatës --

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë të hapur.

GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Përpara se do të ndërpresim do t'ju thoja atë që synoj që të bëjmë nesër, pasi të përfundojmë dëshminë e dëshmitarit që ishte sot dhe do të diskutojmë me palët kalendarin për seancat në vijim të kësaj çështjeje. E gjitha që mund të them për vete dhe gjithë të tjerët është ju lutem merrni kalendarët me vete që të diskutojmë këtë pikë.

Seanca ndërpritet deri nesër në orën 9.30. Faleminderit.

--- Seanca mbyllet në orën 16.10